

Këshilli i Evropës
Komiteti i Ministrave

Rekomandim Rec (2006)5

i Komitetit të Ministrave për Vendet Anëtare

mbi Planin e Veprimit të Këshillit të Evropës për promovimin e të drejtave dhe pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara në Evropë 2006 – 2015.

*(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 5 prill 2006
në takimin e 961-të të Zëvendësministrave)*

Komiteti i Ministrave,

Duke iu referuar rezolutës (59) të 16 nëntorit të vitit 1959, mbi shtrirjen e aktiviteteve të Këshillit të Evropës në fushat sociale dhe kulturore;

*Duke patur parasysh rezolutën (96) 35 të 2 tetorit të vitit 1996, e cila amendoi Marrëveshjen Pjesore në fushën sociale dhe atë të shëndetit publik, nëpërmjet rishikimit të strukturave të Marrëveshjes Pjesore, dhe duke shprehur vendosmërinë për të vazhduar më tej, mbi bazën e rregullave të rishikuara, të cilat zëvendësojnë rregullat e përmbajtura në rezolutën (59) 23, aktivitetet e kryera dhe zhvilluara deri tani mbi bazën e kësaj rregulloreje, të cilat synonin, **inter alia**, integrimin e personave me aftësi të kufizuara në komunitet nëpërmjet përcaktimit dhe mbështetjes së zbatimit në nivel evropian të një modeli politike koherente për personat me aftësi të kufizuara, të bazuar mbi parimet e gëzimit të të drejtave të plota civile, si dhe të drejtës për jetesë së pavarur, çka nënkupton eliminimin e barrierave ndaj integritit, cilado qoftë natyra e tyre, përfshirë barrierat psikologjike, arsimore, familjare, kulturore, profesionale, financiare apo arkitektonike;*

Duke patur parasysh synimin e Këshillit të Evropës për arritjen e një uniteti më të madh midis vendeve anëtare, dhe faktin, se ky synim, mund të realizohet, **inter alia**, nëpërmjet miratimit të rregullave të përbashkëta në fushën e politikave për aftësinë e kufizuar me qëllim promovimin e mbrojtjes së të drejtave politike, civile, sociale, kulturore, dhe arsimore;

Duke patur parasysh Konventën për Mbrojtjen e Të Drejtave dhe Lirive Themelore (ETS Nr.5);

Duke patur parasysh parimet që përmbahen në Kartën Sociale Evropiane të Rishikuar (ETS Nr.163), veçanërisht të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit;

Duke patur parasysh Rregullat Standarde të Kombeve të Bashkuara për Shanse të Barabarta për Personat me Aftësi të Kufizuara, të vitit 1993;

Duke patur parasysh Klasifikimin Ndërkombëtar mbi Funkcionin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin (ICF) të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBT), të vitit 2001;

Duke patur parasysh Konventën mbi Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin (Personat me Aftësi të Kufizuara) të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) (Nr. C159), 1983, dhe Rekomandimet përkatëse të ILO mbi Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin (Nr. R168), 1983;

Duke patur parasysh Rekomandimin Nr. R (92) 6 të Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi një politikë koherente për personat me aftësi të kufizuara;

Duke patur parasysh Deklaratën Ministrore mbi Personat me Aftësi të Kufizuara “Përparim drejt pjesëmarrjes së plotë si qytetarë”, të miratuar në Konferencën e Dytë Evropiane të Ministrave përgjegjës për politikat integruese për personat me aftësi të kufizuara të mbajtur në Malaga (Spanjë) më 7 dhe 8 Maj 2003;

Duke patur parasysh Planin e Veprimit të Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive të Këshillit të Evropës (CM (2005)80 –dokumenti final), miratuar në Varshavë më 17 Maj 2005, i cili përcakton rolin dhe përgjegjësitë kryesore të Këshillit të Evropës në vitet në vazhdim;

Duke patur parasysh Rekomandimin 1592 (2003) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës “Drejt përfshirjes së plotë sociale të personave me aftësi të kufizuara”;

Duke ritheksuar universalitetin, pandashmërinë dhe ndërvarësinë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe nevojën që personave me aftësi të kufizuara t’u garantohet punësim i plotë dhe pa diskriminim;

Duke konsideruar se përqindja e personave me aftësi të kufizuara në Evropë vlerësohet të përbëjë rreth 10-15% të popullatës totale, dhe se arsyeja kryesore e aftësisë së kufizuar janë sëmundjet, aksidentet, kushtet e pamundësisë të të moshuarve për një jetë normale; duke patur parasysh se numri i personave me aftësi të kufizuara pritet të rritet në mënyrë të vazhdueshme midis të moshuarve, dhe duke vlerësuar se numri i personave me aftësi të kufizuara pritet të rritet në mënyrë të qëndrueshme për shkak të rritjes së jetëgjatësisë, *inter alia*;

Duke konsideruar se mungesa e promovimit të të drejtave të qytetarëve me aftësi të kufizuara dhe mosarritja e mundësive të barabarta për qytetarët me aftësi të kufizuara përbën një dhunim të dinjitetit njerëzor;

Duke konsideruar se sigurimi i mundësive të barabarta për anëtarët e të gjitha grupeve shoqërore kontribuon në garantimin e demokracisë dhe kohezionit social;

Duke qenë të bindur se përqasja e bazuar në të drejtat e njeriut për të siguruar integrimin dhe pjesëmarrjen e plotë në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara duhet të përfshihet në të gjitha drejtimit politikbërjes në nivel ndërkombëtar, kombëtar, rajonal dhe lokal;

Duke theksuar nevojën për të integruar aftësinë e kufizuar në të gjitha fushat e jetës përmes politikave koherente dhe veprimeve të bashkërenduara;

Duke njohur punën e kryer nga Komiteti i Këshillit të Evropës për Rehabilitimin dhe Integrimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (CD-P-RR) në hartimin e këtij Plani Veprimi për Aftësinë e Kufizuar;

Duke theksuar rëndësinë e vendosjes së partneritetit me organizatat jo-qeveritare të personave me aftësi të kufizuara në zbatimin dhe monitorimin e Planit të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar,

U rekomandon qeverive të vendeve anëtare, të cilat, duke patur parasysh strukturat e tyre kombëtare, rajonale ose lokale, si dhe përgjegjësitë e tyre specifike duhet të:

- a. Integrojnë, sipas nevojës, në politikat, legjislacionin, si dhe në praktikat e tyre të punës, parimet, dhe masat e përcaktuara në Planin e Veprimit të Këshillit të Evropës për të promovuar të drejtat dhe pjesëmarrjen e plotë të njerëzve me aftësi të kufizuara në shoqëri: të përmirësojnë cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara në Evropë në periudhën 2006-2015, sipas përcaktimeve që përmbahen në shtojcën e këtij rekomandimi;
- b. Promovojnë zbatimin dhe përdorimin e Planit të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar 2006-2015 të Këshillit të Evropës edhe në ato fusha të cilat nuk janë nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të autoriteteve publike, por në të cilat ato mund të ushtrojnë ndikim apo të luajnë një rol të caktuar;
- c. Të garantojnë për këtë qëllim përhapjen sa më të gjerë të këtij rekomandimi midis të gjitha palëve të interesuara, përfshirë nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit dhe bashkërendimit të punës me sektorin privat dhe me shoqërinë civile, duke përfshirë në mënyrë të veçantë organizatat joqeveritare të personave me aftësi të kufizuara.

**Plani i Veprimit të Këshillit të Evropës
për promovimin e të drejtave dhe pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në
shoqëri dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara në Evropë 2006 –
2015.**

Përmbajtja

1. Përmbledhje
2. Hyrje
3. Fushat kryesore të veprimit
 - 3.1. Fusha e Veprimit Nr. 1: Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike
 - 3.2. Fusha e Veprimit Nr. 2: Pjesëmarrja në jetën kulturore
 - 3.3. Fusha e Veprimit Nr. 3: Informimi dhe komunikimi
 - 3.4. Fusha e Veprimit Nr. 4: Arsimimi
 - 3.5. Fusha e Veprimit Nr. 5: Punësimi, orientimi dhe formimi profesional
 - 3.6. Fusha e Veprimit Nr. 6: Përshtatshmëria ndërtimore
 - 3.7. Fusha e Veprimit Nr. 7: Transporti
 - 3.8. Fusha e Veprimit Nr. 8: Jetesa në komunitet
 - 3.9. Fusha e Veprimit Nr. 9: Kujdesi shëndetësor
 - 3.10. Fusha e Veprimit Nr. 10: Rehabilitimi
 - 3.11. Fusha e Veprimit Nr. 11: Mbrojtja sociale
 - 3.12. Fusha e Veprimit Nr. 12: Mbrojtja ligjore
 - 3.13. Fusha e Veprimit Nr. 13: Mbrojtja kundër dhunës dhe abuzimit
 - 3.14. Fusha e Veprimit Nr. 14: Puna kërkimore dhe zhvillimore
 - 3.15. Fusha e Veprimit Nr. 15: Ndërgjegjësimi
4. Aspekte multidisiplinore
 - 4.1. Hyrje
 - 4.2. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara
 - 4.3. Persona me aftësi të kufizuara me nevoja për mbështetje të veçantë
 - 4.4. Fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara
 - 4.5. Moshimi i personave me aftësi të kufizuara
 - 4.6. Personat me aftësi të kufizuara nga rradhët e minoriteteve dhe emigrantëve
5. Zbatimi dhe monitorimi
 - 5.1. Hyrje
 - 5.2. Zbatimi
 - 5.3. Monitorimi

- Shtojca 1 Deklarata Ministeriale e Malagës për Personat me Aftësi të Kufizuara “Duke ecur drejt pjesëmarrjes së plotë si qytetarë” e miratuar në Konferencën e Dytë Evropiane të Ministrave përgjegjës për politikat integruese për personat me aftësi të kufizuara, zhvilluar në Malaga (Spanjë), më 7-8 Maj 2003.
- Shtojca 2 Tekste reference

1. Përmbledhje

1.1. Misioni

1.1.1. Deklarata Ministeriale e Malagës për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Në 1992, bazuar në Konferencën e parë Evropiane të Ministrave përgjegjës për politikën për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht në Rekomandimin Nr. R (92) 6, u hartua dhe miratua një politikë koherente për personat me aftësi të kufizuara edhe nga Komiteti i Ministrave.

Ky rekomandim, i cili ndikoi në politikën e aftësisë së kufizuar për më tepër se 10 vjet, ka nxitur hartimin e planeve të reja, si dhe zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse, në favor të të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Megjithatë, gjatë dekadave në vazhdim, në shoqëri kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme dhe si pasojë ka lindur domosdoshmëria për hartimin e strategjive të reja në funksion të progresit të mëtejshëm në çështjet e aftësisë së kufizuar si në aspektin social, ashtu edhe në atë të të drejtave të njeriut.

Në Maj 2003, gjatë Konferencës së Dytë Ministeriale Evropiane, e cila u zhvillua në Malagë të Spanjës, ministrat përgjegjës për politikën për personat me aftësi të kufizuara, miratuan Deklaratën Ministeriale të Malagës “Duke ecur drejt pjesëmarrjes së plotë si qytetarë” për personat me aftësi të kufizuara.

Për këtë arsye u hartua një strategji, e shoqëruar nga një Plan Veprimi i Këshillit të Evropës për Aftësinë e Kufizuar, i cili synon të mbështesë promovimin e të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara në Evropë.

1.1.2. Misioni i deklaratës

Plani i Veprimit të Këshillit të Evropës për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar 2006-2015 synon të konkretizojë qëllimet e Këshillit të Evropës lidhur me të drejtat e njeriut, anti-diskriminimin, shanset e barabarta, pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuar në një program politik për dekadën e ardhshme.

Ky Plan Veprimi ka për qëllim të krijojë premisat për zhvillimin e një programi gjithëpërfshirës, i cili do të do të ketë mundësinë të përshtatet me kushtet specifike të vendeve të cilat do ta zbatojnë atë. Gjithashtu, ky Plan Veprimi synon të shërbejë si një hartë për politikëbërësit, t'i nxisë ata të planifikojnë, përmirësojnë, rifokusojnë dhe zbatojnë plane, programe dhe strategji të reja.

Këshilli i Evropës do të mbështesë zbatimin Planin e Veprimit të Aftësisë së Kufizuar, duke siguruar asistencë për të gjitha shtetet anëtare në formën e rekomandimeve, këshillimeve dhe informimit nga ekspertët.

1.2. Parimet themelore dhe objektivat strategjike

1.2.1. Parimet themelore

Vendet anëtare do të vazhdojnë punën brenda kuadrit të të drejtave njerëzore dhe antidiskriminimit për rritjen e nivelit të pavarësisë, lirisë së zgjedhjes dhe cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit mbi aftësinë e kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor.

Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar instrumentave përkatës evropianë dhe ndërkombëtarë, traktateve dhe planeve, veçanërisht zhvillimeve të fundit lidhur me projektrezolutën ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Strategjia e Re për Kohezion Social e Këshillit të Evropës (2004) shtron nevojën e angazhimit të veçantë përkundrejt mundësisë të gëzimit të të drejtave të njeriut për ata që rrezikojnë të përjashtohen nga shoqëria; këtu renditen fëmijët, të rinjtë, migrantët, pakicat etnike, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.

Plani i Veprimit për Aftësi të Kufizuar njih parimin themelor të detyrimit të shoqërisë përkundrejt të gjithë qytetarëve të saj, përsa i përket minimizimit të të gjitha pasojave të aftësisë së kufizuar nëpërmjet mbështetjes aktive të mënyrave të shëndetshme të jetesës, mjediseve të sigurta dhe kujdesit shëndetësor për të gjithë, si dhe nëpërmjet rehabilitimit dhe komuniteteve të hapura për personat me aftësi të kufizuara.

1.2.2. Objektivat strategjike

Objektivi kryesor i Planit të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar është të shërbejë si një instrument praktik për hartimin dhe zhvillimin e strategjive të zbatueshme me qëllim realizimin e pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, si dhe integrimin e aftësisë së kufizuar në të gjitha fushat e politikbërjes së vendeve anëtare. Plani i Veprimit synon të reflektojë kushtet specifike të vendeve anëtare, si dhe të marrë parasysh proceset e tranzicionit të cilat prekin disa nga vendet anëtare.

Plani i veprimit përfshin rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve specifike në nivel kombëtar, si dhe dhënien e sqarimeve lidhur me grupet veçanërisht në nevojë të personave me aftësi të kufizuara, të cilët përballen me barriera dhe probleme specifike, zgjidhja e të cilave kërkon një përqasje multidisiplinore.

Plani i veprimit nxit vendet anëtare t'u përgjigjen nevojave të personave me aftësi të kufizuara duke mundësuar dhënien e shërbimeve cilësore dhe inovative, si dhe duke konsoliduar masat e marra deri tani.

Plani i veprimit synon të shërbejë si një pikë reference edhe për sektorin privat, organizatat joqeveritare, dhe organizatat ndërkombëtare. Ai i konsideron organizatat joqeveritare të ngritura nga personat me aftësi të kufizuara si partnerë kompetentë dhe ekspertë të politikbërjes, të cilët duhet të konsultohen si palë të interesuara në proceset vendimmarrëse me ndikim në jetën e tyre. Zbatimi i planit të veprimit do të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë periodike, në mënyrë që të identifikohet progresi i arritur në nivel kombëtar, si dhe të mundësohet shkëmbimi i praktikave të mira.

1.3. Fushat kryesore të veprimit

Plani i Veprimit të Këshillit të Evropës mbi Aftësinë e Kufizuar ka një fushëveprim të gjerë, i cili përfshin të gjithë aspektet kryesorë të jetës së personave me aftësi të kufizuara. Këto aspekte kryesore reflektohen në 15 fushat e veprimit, të cilat rendisin objektivat kryesorë si dhe masat specifike të cilat duhet të merren nga vendet anëtare.

Fushat e veprimit përbëjnë thelbin e planit të veprimit. Ato mbulojnë 15 aspektet e mëposhtëm:

- Fusha e Veprimit Nr. 1: Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike
- Fusha e Veprimit Nr. 2: Pjesëmarrja në jetën kulturore
- Fusha e Veprimit Nr. 3: Informimi dhe komunikimi
- Fusha e Veprimit Nr. 4: Arsimimi
- Fusha e Veprimit Nr. 5: Punësimi, orientimi dhe formimi profesional
- Fusha e Veprimit Nr. 6: Përshtatshmëria ndërtimore
- Fusha e Veprimit Nr. 7: Transporti
- Fusha e Veprimit Nr. 8: Jetesa në komunitet
- Fusha e Veprimit Nr. 9: Kujdesi shëndetësor
- Fusha e Veprimit Nr. 10: Rehabilitimi
- Fusha e Veprimit Nr. 11: Mbrojtja sociale
- Fusha e Veprimit Nr. 12: Mbrojtja ligjore
- Fusha e Veprimit Nr. 13: Mbrojtja kundër dhunës dhe abuzimit
- Fusha e Veprimit Nr. 14: Puna kërkimore dhe zhvillimore
- Fusha e Veprimit Nr. 15: Ndërgjegjësimi

Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike (Nr.1), si dhe në proceset demokratike ka rëndësi të dorës së parë në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e shoqërive demokratike. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësinë të ndikojnë në fatin e komuniteteve të tyre. Për këtë arsye, është veçanërisht e rëndësishme pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet politike dhe publike, si dhe ushtrimi nga ana e tyre e të drejtës së votës.

Pjesëmarrja në jetën kulturore (Nr.2) është parakusht për integrimin e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Kjo kërkon marrjen e masave për sigurimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën dhe shoqatat kulturore, në mënyrë që ata të kultivojnë dhe përdorin potencialin e tyre krijues dhe intelektual për të mirën e tyre dhe të komunitetit.

Në këtë aspekt, qasja në informacion dhe komunikim (Nr.3) përbën gjithashtu një parakusht të integritimit. Është e domosdoshme që organizmat publike dhe private të informimit dhe komunikimit të marrin parasysh nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Kjo kërkon marrjen e masave për mundësimin e dhënies dhe marrjes së informacionit në mënyrë të barabartë nga ana e personave me aftësi të kufizuara, në një shoqëri e cila mbron shanset e barabarta.

Qasja e barabartë ndaj arsimimit (Nr.4) është një parakusht themelor për garantimin e përfshirjes sociale si dhe të pavarësisë për personat me aftësi të kufizuara. Arsimimi duhet të shtrihet përgjatë të gjithë fazave të jetës, duke filluar nga arsimi parashkollor, e duke vazhduar me arsimin profesional, si dhe me të mësuarit gjatë të gjithë jetës.

Arsimi i përgjithshëm dhe ai i specializuar duhet të nxiten të punojnë së bashku për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara edhe nëpërmjet punës në komunitetet e tyre lokale. Një përjasje integruese mund të ndikojë në ndërgjegjësimin e personat me aftësi jo të kufizuara lidhur me të kuptuarit e diversitetit njerëzor.

Punësimi, orientimi dhe formimi profesional (Nr.5) janë faktorë kryesorë për përfshirjen sociale dhe arritjen e pavarësisë ekonomike të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër del i nevojshëm rishikimi i legjislacionit, si dhe masave dhe shërbimeve të nevojshme për garantimin e shanseve të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në fushën e punësimit. Shanset e barabarta në fushën e punësimit duhet të promovohen nëpërmjet kombinimit të masave anti-diskriminuese me masat e “veprimet pozitiv”, si dhe duke integruar çështjet specifike që kanë të bëjnë me punësimin e personave me aftësi të kufizuara në politikat e përgjithshme të punësimit.

Një mjedis ndërtimor pa barriera (Nr.6) nxit shanset e barabarta, jetesën e pavarur, përfshirjen aktive në jetën e komunitetit dhe mundëson punësimin. Zbatimi i parimeve të projektimit universal bën të mundur realizimin e një mjedisi që mundëson aksesin e personave me aftësi të kufizuara në njërën anë, dhe parandalon krijimin e barrierave të reja nga ana tjetër.

Zhvillimi dhe realizimi i transportit të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara (Nr.7) në të gjitha nivelet duhet të mundësojë një përmirësim të qenësishëm të përdorimit të shërbimeve të transportit për pasagjerë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara. Ky është një parakusht për arritjen e pavarësisë së tyre, të shoqëruar me pjesëmarrjen e plotë në tregun e punës dhe pjesëmarrjen aktive në jetesën në komunitet.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë të aftë të jetojnë në mënyrë sa më të pavarur. Ata duhet të jenë në gjendje të zgjedhin se ku dhe se si duhet të jetojnë. Mundësitë për jetesë të pavarur dhe përfshirje sociale janë të parat që krijohen nëpërmjet të jetuarit në komunitet. Përmirësimi i jetesës në komunitet (Nr.8) kërkon hartimin e politikave strategjike të cilat të mbështesin kalimin nga kujdesi në nivel institucioni në kujdesi i bazuar në komunitet, i cili përfshin mundësimin e jetesës së pavarur brenda komuniteteve të vogla. Ky objektiv duhet të mbështetet nga një përjasje e bashkërenduar në dhënien e shërbimeve të orientuara nga përfituesi, të bazuara në komunitet, dhe të ndërtuara rreth personit.

Personat me aftësi të kufizuara, ashtu si personat pa aftësi të kufizuara kanë nevojë për një nivel adekuat të kujdesit shëndetësor (Nr.9) dhe shanse të barabarta për shfrytëzimit të shërbimeve cilësore shëndetësore, të cilat respektojnë të drejtat e klientit. Në këtë aspekt, trajnimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor lidhur me modelin social të aftësisë së kufizuar merr rëndësi të dorës së parë.

Shmangja e përkeqësimit të aftësisë së kufizuar, lehtësimi i pasojave të saj dhe rritja e shkallës së pavarësisë së personave me aftësi të kufizuara, dhe rehabilitimi i plotë (Nr.10) kërkon zbatimin e një sërë programesh të shfrytëzueshme nga personat me aftësi të kufizuara. Aty ku është e nevojshme, këto shërbime duhet të jenë të bazuara në komunitet.

Shërbimet e ofruara nga sistemi i mbrojtjes sociale (Nr.11) – ku përfshihen sigurimet shoqërore, asistencë sociale, etj, mund të kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e cilësisë së jetesës së përfituesve. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësinë të përfitojnë nga sistemet e mbrojtjes sociale, dhe të gëzojnë qasje të barabartë në to. Politikat, të cilat nxisin kalimin nga varësia nga pagesat e aftësisë së kufizuar drejt pavarësisë që sjell me vete punësimi dhe vendimmarrja e pavarur duhet të promovohen me sa të jetë e mundur.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësinë e shfrytëzimit të sistemit të drejtësisë dhe mbrojtjes ligjore në të njëjtën masë si dhe qytetarët e tjerë. Mbrojtja ligjore (Nr.12) përmban një tërësi masash për eliminimin e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara. Për këtë qëllim, del i nevojshëm krijimi dhe zhvillimi i një kuadri adekuat legal dhe administrativ për parandalimin e eliminimin e diskriminimit.

Shoqëria ka për detyrë mbrojtjen e të gjithë individëve ndaj akteve të dhunës dhe abuzimeve (Nr.13) si dhe parandalimin e këtyre akteve. Në këtë aspekt, vërehet nevoja e hartimit dhe zbatimit të politikave për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga të gjitha llojet e abuzimeve dhe dhunës, si dhe mundësimi i mbështetjes adekuate për viktimat e dhunës dhe abuzimeve.

Puna kërkimore dhe zhvillimore (Nr.14) mbledhja e të dhënave statistikore dhe analizimi i tyre qëndrojnë në thelb të hartimit dhe zbatimit të politikave të mirëinformuara dhe të bazuara në fakte reale. Informacioni i saktë dhe i besueshëm ndihmon në identifikimin e problemeve të reja dhe në gjetjen e zgjidhjeve adekuate. Ai ka rëndësi edhe përsa i përket identifikimit të praktikave të mira të punës dhe monitorimin e ndryshimeve që ndodhin në shoqëri.

Ndërgjegjësimi (Nr.15) është një çështje e dorës së parë e cila qëndron në thelb të të gjithë planit të veprimit. Sjellja diskriminuese dhe stigmatizimi duhet të zëvendësohen nga informacion objektiv dhe i përdorshëm nga të gjithë, i cili duhet të vërë në pah pasojat e aftësisë së kufizuar në funksion të kuptimit më të mirë të të drejtave dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Në këtë aspekt, del e nevojshme marrja e masave për ndryshimin e mentaliteteve dhe qëndrimeve negative

përkundrejt personave me aftësi të kufizuara, çka nënkupton integrimin e çështjes së aftësisë së kufizuar në të gjitha botimet zyrtare si dhe në produktet e medias.

1.4. Aspektet ndërdisiplinore

Në gjirin e popullatës evropiane me aftësi të kufizuara ekzistojnë persona me aftësi të kufizuara të cilët përballen me barriera të veçanta, apo me diskriminim të dyfishtë.

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për një nivel të lartë mbështetjeje, fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, personat e moshuar me aftësi të kufizuara, si dhe personat me aftësi të kufizuara nga emigrantët dhe minoritetet përballen me një risk më të lartë të përjashtimit dhe në përgjithësi përfaqësohen më pak në shoqëri sesa personat e tjerë me aftësi të kufizuara.

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen shpeshherë me barriera të shumëfishta për pjesëmarrjen në shoqëri. Kjo ndodh për shkak të kombinimit të diskriminimit mbi baza gjinore me diskriminimin për shkak të aftësive të kufizuara. Situata e veçantë e këtyre grave dhe vajzave duhet të merret në konsideratë gjatë hartimit të politikave lidhur me aftësi të kufizuara, si dhe përgjatë procesit të integritit të çështjes së aftësisë së kufizuar në të gjitha programet dhe nivelet.

Njëri nga grupet më në nevojë ndër personat me aftësi të kufizuara përbëhet nga njerëzit, të cilët, për shkak të shkallës së rëndë të dëmtimit apo për shkak të kompleksitetit të aftësisë së tyre të kufizuar, kanë nevojë për një shkallë më të lartë mbështetjeje. Cilësia e jetës së këtyre personave varet në mënyrë thelbësore nga ekzistenca dhe cilësia e shërbimeve përkatëse, si dhe nga mbështetja intensive dhe specifike ndaj tyre. Për plotësimin e nevojave të këtyre personave, del i nevojshëm planifikimi dhe bashkërendimi i punëve midis autoriteteve të ndryshme qeveritare, si dhe ofruesve të shërbimeve.

Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe mundësi si fëmijët e tjerë, në përputhje me dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Të rinjtë me aftësi të kufizuara përbëjnë gjithashtu një grup me nevoja mjaft specifike në shoqërinë tonë. Ata vazhdojnë të përballen me pengesa të konsiderueshme në të gjitha fushat e jetës. Problemet specifike të hasura nga fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara duhet të studjohen më në thellësi, në mënyrë që të mundësohet hartimi dhe zbatimi i politikave të mirëinformuara ndërsektoriale.

Moshimi i vazhdueshëm i personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht i atyre të cilët kanë nevojë për mbështetje dhe ndihmesë intensive, paraqet një sfidë gjithnjë e më të madhe për shoqërinë evropiane. Në këtë aspekt del e nevojshme gjetja e përqsasjeve të reja për t'iu përgjigjur atyre në një front të gjerë politikash dhe shërbimesh.

Personat me aftësi të kufizuara nga minoritetet dhe komunitetet e emigrantëve mund të përballen me vështirësi të shumëllojta për shkak të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose për shkak të mosnjohjes së funksionimit të sistemeve të shërbimeve publike. Për këtë arsye, del e nevojshme një përqsasje tërësore, e cila duhet të marrë parasysh dimensionin kulturor, gjuhësor si dhe nevojat e veçanta të këtyre grupeve.

Grupet e lartpërmendur të personave me aftësi të kufizuara duhet të përfshihen në shoqëri nëpërmjet një sërë masash dhe politikash ndërdisiplinore. Nga ana e tyre, politikbërësit duhet të jenë në dijeni të pengesave dhe sfidave me të cilat përballlet secili prej këtyre grupeve dhe të reagojnë nëpërmjet

politikave dhe masave të cilat duhet të merren në mënyrë ndërdisiplinore përgjatë disa fushave të veprimit njëkohësisht, për të siguruar kapërcimin e pengesave dhe shfrytëzimin maksimal të potencialeve të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë aspekt, del i nevojshëm zbatimi i një përqasjeje të dyfishtë, e cila e merr pikënisjen si nga ky Plan Veprimi, ashtu edhe nga Strategjia e Re e Këshillit të Evropës për Kohezion Social (2004). Kjo përqasje nevojitet për të promovuar zhvillimin e politikave të reja efektive, të integruara dhe ndërdisiplinore.

1.5. Zbatimi dhe Monitorimi

Në përputhje me parimet themelore të cilët shërbejnë si pikënisje për fushat e veprimit dhe për aspektet ndërdisiplinore, parimet e projektimit universal, cilësisë, trajnimit dhe integritit përbëjnë elementët kyç të strategjisë së zbatimit të planit të veprimit për aftësinë e kufizuar. Zbatimi i parimeve të projektimit universal ka rëndësi thelbësore për përmirësimin e përshtatshmërisë ndërtimore dhe mjedisore, si dhe për rritjen e shkallës së përdorshmërisë së produkteve. Një tjetër aspekt thelbësor është bashkërendimi i politikave, masave dhe shërbimeve me standarde më të larta të cilësisë. Rol të veçantë në këtë drejtim luan përqasja integruese në hartimin e politikave dhe dhënien e shërbimeve, çka pa dyshim promovon një shoqëri të hapur dhe njëkohësisht më përfshirëse.

Vendet anëtare mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për zbatimin e politikave të aftësisë së kufizuar në nivel kombëtar. Vendet anëtare mbajnë përgjegjësi të veçantë për zbatimin e masave specifike që u referohen atyre në çdo fushë veprimi. Vendet anëtare duhet të fillojnë me vlerësimin e politikave ekzistuese si dhe parimeve që i mbështesin ato përkundrejt drejtimeve të punës të përcaktuara në Planin e Veprimit për Aftësinë e Kufizuar, në mënyrë që të identifikojnë fushat ku ka ende punë për të bërë, si edhe masat që duhet të merren me këtë qëllim.

Vendet anëtare duhet t'i referohen këtij vlerësimi përgjatë hartimit të strategjive që synojnë përafrimin e politikave të tyre me rekomandimet dhe parimet thelbësore të Planit të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar brenda kuadrit të resurseve financiare kombëtare.

Vendet anëtare duhet të përpiqen të gjejnë përqasje të përbashkëta në kuadër të partneriteteve me palët e interesuara, veçanërisht me organizatat joqeveritare të personave me aftësi të kufizuara, si në zbatimin, ashtu edhe në vlerësimin e Planit të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar.

Deri tani, me qëllim sigurimin e një ndërgjegjësimi më të madh përsa i përket zbatimit të këtij planveprimi, janë konsultuar të gjitha organizmat dhe komitetet e Këshillit të Evropës.

Komiteti i Ministrave do të ngrejë një forum të veçantë i cili do të ngarkohet me menaxhimin e procesit të monitorimit të planveprimi. Ky forum do t'u rekomandojë vendeve anëtare që të analizojnë në detaj çështje prioritare specifike. Parakusht për monitorimin efektiv të Planit për Aftësinë e Kufizuar është dhënia e rregullt e informacioneve nga ana e vendeve anëtare.

Forumi do të garantojë informimin e vazhdueshëm të Komitetit të Ministrave lidhur me progresin e arritur në zbatimin e Planit të Veprimit mbi Aftësinë e Kufizuar.

2. Hyrje

2.1. Misioni

Plani i Veprimit ka për qëllim të transmetojë synimet e Këshillit të Evropës në fushën e të drejtave të njeriut, jodiskriminimit, shanseve të barabarta, të drejtave civile dhe pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në një kuadër evropian të aftësisë së kufizuar për dekadën në vazhdim.

Ky Plan Veprimi synon të krijojë një kuadër tërësor, i cili duhet të jetë fleksibël dhe të mund të përshtatet me kushtet specifike të vendeve anëtare. Ai synon të hedhë piketat për politikbërësit, në mënyrë që ata të kenë mundësinë të hartojnë politika, ti përshtasin ato, të rifokusohen mbi prioritetet, dhe të zbatojnë plane, programe dhe strategji adekuate.

Këshilli i Evropës do të vazhdojë përpjekjet për zbatimin e planit të veprimit duke u dhënë asistencë vendeve anëtare nëpërmjet rekomandimeve, këshillave dhe informacionit në nivel ekspertësh.

2.2. Ndryshimi i paradigmës - nga pacienti në qytetar

Dekada e shkuar është shënuar nga ndryshime të mëdha politike, ekonomike, sociale dhe teknologjike në Evropë. Sfidat dhe mundësitë e globalizimit, zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, ndryshimi i modeleve të punësimit dhe papunësia, ndryshimet në skemat shëndetësore, demografike, migrimi si dhe tranzicioni i shumë vendeve drejt ekonomive të tregut po e transformojnë gjithnjë e më shumë rajonin. Shumë prej këtyre ndryshimeve kanë kahje pozitive, çka ka bërë të lindin pritshmëri të reja.

Tashmë personi me aftësi të kufizuara nuk shihet më si një pacient, i cili ka nevojë thjesht dhe vetëm për trajtim dhe përkujdesje, apo që nuk kontribuon në shoqëri. Tashmë, personi me aftësi të kufizuara shihet si një person, i cili ka nevojë të kapërcejë pengesat aktuale, në mënyrë që të zërë vendin e tij si një anëtar me të drejta të plota në shoqëri. Ndër këto pengesa renditen mentalitetet e prapambetura si dhe barrierat sociale, ligjore e mjedisore. Për këtë arsye, ne duhet të mbështesim edhe më shumë ndryshimin e paradigmës nga modeli i vjetër mjekësor i aftësisë së kufizuar, drejt modelit social të bazuar në të drejtat e njeriut.

Tashmë fokusi është zhvendosur drejt individit si pika qendrore e një përjasjeje koherente dhe të integruar, e cila respekton të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe dinjitetin e të gjithë individëve me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye, në shumë vende Evropiane vërehet prirja për të promovuar politika aktive, të cilat u mundësojnë individëve me aftësi të kufizuara të kontrollojnë vetë jetën e tyre. Njëkohësisht, vihet re edhe rritja e vazhdueshme e rolit të organizatave joqeveritare në përgjithësi, dhe e organizatave joqeveritare të personave me aftësi të kufizuara në veçanti, të cilat janë shndërruar në partnerë të qeverive dhe të personave me aftësi të kufizuara, duke luajtur rolin e avokatit, dhënësit të shërbimeve, apo burimit të përvojës dhe njohurive profesionale.

Ky Plan Veprimi është hartuar për tu lënë vend ndryshimeve përgjatë zbatimit të tij, në mënyrë që të reflektojë ndryshimet e pritshme në teknologji dhe në fusha të tjera.

Zhvillimet e fundit në fushën e bioteknologjisë dhe përdorimet e mundshme të saj kanë krijuar shqetësime midis personave me aftësi të kufizuara, duke qenë se në disa raste vihet në pikëpyetje edhe e drejta e jetës. Ky plan trajton çështjen e përfshirjes së plotë sociale dhe atë të pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara, për këtë arsye nuk është quajtur me vend të trajtojë, krahas këtyre çështjeve, edhe çështjet me karakter të theksuar mjekësor si diagnoza prenatale apo diskriminimi mbi baza të aftësisë së kufizuar në ligjet e abortit.

Megjithatë nuk ekziston asnjë dyshim lidhur me rëndësinë e çështjeve të lartpërmendura. Për këtë arsye, pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në komitetet ndërkombëtare të etikës dhe bioetikës nëpërmjet organizmave të tyre përfaqësuese merr rëndësi të veçantë.

2.3. Deklarata Ministeriale e Malagës

Konferenca e Dytë Evropiane e Ministrave përgjegjës për politikën e integritetit të personave me aftësi të kufizuara e mbajtur në Malaga të Spanjës më 7 dhe 8 Maj të vitit 2003, synonte të ecte nën shembullin e Konferencës së Parë Evropiane të Ministrave të mbajtur në vitin 1991. Ajo miratoi rekomandimin Nr. R (92) 6 mbi politikën koherente për personat me aftësi të kufizuara. Ky rekomandim, i miratuar më 9 prill të vitit 1992, ndikoi në politikën e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës mbi aftësinë e kufizuar për më shumë se dhjetë vjet dhe shërbeu si pikënisje e politikave gjithëpërfshirëse në favor të personave me aftësi të kufizuara, si në nivelin kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Nëpërmjet Deklaratës Ministeriale të Malagës, me titullin “Duke ecur drejt pjesëmarrjes së plotë si qytetarë”, e miratuar në konferencë, ministrat pjesëmarrës theksuan se qëllimi i tyre për dekadën e ardhshme ishte përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre. Në këtë drejtim del i nevojshëm hartimi i një strategjie të re e cila duhet të pasqyrojë si modelin social të aftësisë së kufizuar, ashtu edhe pritshmëritë në rritje të personave me aftësi të kufizuara dhe të shoqërisë.

Ministrat theksuan se kjo strategji duhet të pasqyrohet në një Plan Veprimi, hartimi i të cilit do të mundësojë eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga mosha. Plani i Veprimit duhet t’i kushtojë një vëmendje të veçantë grave me aftësi të kufizuara, personave me aftësi të kufizuara me nevoja të veçanta, si dhe të moshuarve me aftësi të kufizuara, me qëllim që atyre tu garantohen të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe të drejtat civile.

2.4. Kuadri i të drejtave të njeriut

Këshilli i Evropës dhe vendet anëtare do të vazhdojnë përpjekjet e tyre për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga çfarëdolloj forme diskriminimi apo abuzimi, brenda kuadrit të të drejtave të njeriut. Këshilli i Evropës do të punojë për të integruar shanset e barabarta për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e politikbërjes.

Gjatë hartimit të Planit të Veprimit, vendet anëtare kanë patur parasysh ndikimin e traktateve ligjorë ekzistues, instrumentave ligjorë, standardeve dhe politikave të cilat mbështesin trajtimin e barabartë dhe të drejtat njerëzore të personave me aftësi të kufizuara.

Rekomandimi i komitetit të ministrave Nr. R (92) 6 ka hedhur baza të shëndosha në nivel evropian. Legjislacioni dhe programet e Bashkimit Evropian kanë hedhur hapa të mëtejshëm, ndërsa plani i veprimit i Komisionit Evropian do të përvijojë mënyrën me të cilën do të hartohen dhe do të zbatohen politikat e aftësisë së kufizuar nga institucionet evropiane.

Strategjia e Re për Kohezion Social e Këshillit të Evropës (2004) përfshin një angazhim të veçantë ndaj realizimit të të drejtave të atyre individëve dhe grupeve shoqërore që rrezikojnë të vuajnë pasojat e përjashtimit shoqëror.

Përveç instrumentave ekzistues në nivel evropian, ky plan veprimi merr në konsideratë Rregullat Standarde të Kombeve të Bashkuara për Barazimin e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara, traktatet kryesore të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, si dhe zhvillimet e fundit që kanë të bëjnë me hartimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

2.5. Objektivat strategjike

Objektivi thelbësor i këtij plani veprimi është realizimi i pjesëmarrjes së plotë shoqërore të personave me aftësi të kufizuara si dhe integrimi përfundimtar i çështjeve të aftësisë së kufizuar në të gjitha fushat e politikbërjes.

Plani i veprimit krijon një kuadër tërësor të përbërë nga rekomandime specifike, të cilët mund të përshtaten për t'u përdorur me efektivitet përkundrejt kushteve specifike të vendeve të ndryshme. Plani merr parasysh diversitetin gjeografik, ekonomik, kulturor dhe social të vendeve anëtare dhe njeh faktin se disa nga vendet anëtare gjenden ende në proces tranzicioni. Plani është hartuar me qëllim që të shërbejë si një instrument praktik dhe të vendosë piketat për politikbërësit në mënyrë që ata të hartojnë, zhvillojnë dhe zbatojnë strategji të fokusuara mbi prioritetet kyçe.

Plani do të ndihmojë si ato vende anëtare që duan të hartojnë planet e tyre kombëtare të veprimit për integrimin e qytetarëve të tyre me aftësi të kufizuara, ashtu edhe ato vende që tashmë i kanë hartuar këto politika dhe planifikojnë zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Plani do të ndihmojë vendet anëtare të promovojnë politika aktive për eliminimin e diskriminimit dhe promovimin e të drejtës për të patur shanse të barabarta, të cilat do të plotësohen me mjete efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte në rast se shkelet.

Plani nxit vendet anëtare tu përgjigjen nevojave të personave me aftësi të kufizuara duke dhënë shërbime cilësore dhe inovative si dhe duke konsoliduar masat e marra deri tani.

Plani është një burrim i dobishëm informacioni dhe frymëzimi për ndërmarrjet private, organizatat joqeveritare si dhe organizatat ndërkombëtare.

Së fundmi, ky plan veprimi promovon konceptin thelbësor sipas të cilit personat me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e tyre duhet të pyeten dhe të konsiderohen si partnerë primarë në proceset vendimmarrëse të cilat ndikojnë në jetën e tyre, qoftë në nivel kombëtar, qoftë në raste individuale.

Zbatimi i planit të veprimit do të vlerësohet në mënyrë të rregullt në mënyrë që të identifikohet progresi i arritur dhe të shkëmbehen praktikat e mira. Vlerësimi i planit të veprimit duhet të mbështetet në mekanizma efektivë dhe të qëndrueshëm, të cilët do të mundësojnë vlerësimin e rezultateve në nivel kombëtar.

2.6. Struktura dhe përmbajtja

Plani i veprimit ka një fushë të gjerë veprimi, e cila përfshin të gjitha sferat e jetës së personave me aftësi të kufizuara; strehimin, arsimimin, punësimin, lëvizjen e lirë dhe ndërgjegjësimin. Këto aspekte të rëndësishme pasqyrohen në fushat e veprimit që përbëjnë thelbin e planit të veprimit.

Plani përmban edhe aspekte ndërdisiplinore, që kanë të bëjnë me gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, të moshuarit me aftësi të kufizuara, personat me aftësi të kufizuara me nevoja të veçanta si dhe me personat me aftësi të kufizuara nga minoritetet dhe emigrantët.

Plani i veprimit u kushton vëmendje instrumentave ekzistues në nivel evropian dhe ndërkombëtar, traktateve, planeve dhe zhvillimeve që kanë të bëjnë me Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Parimet themelore që mbështesin këtë plan veprimi përfshijnë jodiskriminimin, shanset e barabarta, pavarësinë, si dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara.

Elementët kyç të planit të veprimit janë parimet gjithëpërfshirës dhe themelore, fushat prioritare të veprimit, aspektet ndërdisiplinore, mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit si dhe një proces zbatimi i ndarë në faza.

Ky plan veprimi nuk përmban ndonjë përcaktim të aftësisë së kufizuar. Komiteti ishte i mendimit se përcaktimi i aftësisë së kufizuar është një çështje e brendshme e secilit vend anëtar dhe i politikave të tyre.

Gjithashtu, plani i veprimit nuk përmban një fushë specifike veprimi lidhur me çështjen e parandalimit. Parandalimi është një çështje me shumë rëndësi për personat me aftësi të kufizuara, personat pa aftësi të kufizuara si dhe për qeveritë, duke qenë se efektet e aftësisë së kufizuar ndikojnë mbi individët, familjet dhe shoqërinë në përgjigjësi.

Në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar për Funkcionimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin (ICF)¹ të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ky plan veprimi trajton parandalimin e kufizimeve të aktivitetit si dhe parandalimin e kufizimeve në pjesëmarrje në tërësinë e tyre. Plani i veprimit e njeh ICF-në dhe nxit vendet anëtare ta përdorin atë si kuadër standardizimi.

Komiteti ishte i mendimit se zhvillimi i vazhdueshëm në fushën e trajtimit mjekësor, veçanërisht zhvillimet në fushën e identifikimit të aftësisë së kufizuar, si dhe përparimet në fushën e politikave të shëndetit publik duhet të bëhen objekt i punës së komiteteve të ndryshme të Këshillit të Evropës.

¹ Gjenevë, 2001.

Plani i veprimit i përmbahet parimit, sipas të cilit shoqëria mban përgjegjësi përballë të gjithë qytetarëve të saj për minimizimin e pasojave të aftësisë së kufizuar, i cili arrihet nëpërmjet mbështetjes së të gjitha mënyrave të jetesës së shëndetshme, mjediseve të sigurta dhe jetesës në komunitet. Ky parim reflektohet në të gjitha fushat e veprimit të këtij plani, veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor dhe rehabilitimin.

2.7. Parimet themelore

Parimet themelore që përcaktojnë drejtimit kryesore të punës së këtij plani veprimi janë:

- jo-diskriminimi;
- shanset e barabarta;
- pjesëmarrja e plotë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në shoqëri;
- respekt për dallimet dhe pranim i aftësisë së kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor;
- dinjtitet dhe autonomi individuale, e cila përfshin lirinë e vendimmarrjes;
- barazi gjinore;
- pjesëmarrje e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha vendimet që ndikojnë në jetën e tyre, qoftë si individë, qoftë si organizata përfaqësuese.

2.8. Proçedura

Proçesi i hartimit të Planit të Veprimit filloi në sesionin e 26-të të Komitetit për Rehabilitimin dhe Integrimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (Marrëveshja Pjesore) (CD-P-RR), i cili u mbajt në tetor të vitit 2003. Ky proçes u mbështet nga një grup pune i mandatuar nga CD-P-RR dhe nga një grup ad-hoc.

Ky plan veprimi merr në konsideratë rolin e organizatave joqeveritare të personave me aftësi të kufizuara, si burim ekspertize dhe si partnerë kompetentë në hartimin e politikave. Forumi Evropian i Aftësisë së Kufizuar, i cili përfaqëson organizatat e personave me aftësi të kufizuara në nivel evropian, ka luajtur një rol aktiv në hartimin e Planit të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar të Këshillit të Evropës.

Në proçesin e hartimit të këtij plani veprimi janë konsultuar të gjitha organizmat dhe komitetet e Këshillit të Evropës, në mënyrë që të garantohej një ndërgjegjësim i lartë lidhur me nevojën e zbatimit të tij.

3. Fushat kryesore të veprimit

Plani i Veprimit ravijëzon masa specifike, të cilat duhet të merren në kuadër të një spektri të gjerë të politikbërjes. Kombinimi i këtyre masave specifike krijon një kuadër tërësor, si për zhvillimin e politikave dhe strategjive për personat me aftësi të kufizuara, ashtu edhe për integrimin e tyre në vendimmarrjen kombëtare, në mënyrë që të promovohet dhe arrihet pjesëmarrja e plotë e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

Këto fusha veprimi mbështeten në Deklaratën Ministrore të Malagës për Personat me Aftësi të Kufizuara, e cila u miratua në Konferencën e Dytë të Ministrave Evropianë mbi Politikën e Integritit të Aftësisë së Kufizuar, e mbajtur në Malagë të Spanjës në Maj të vitit 2003. Gjithashtu, ato mbështeten

në rekomandimin Nr. R (92) të Këshillit të Evropës mbi një politikë koherente për personat me aftësi të kufizuara dhe për zhvillimet evropiane në përgjithësi.

Çdo fushë veprimi përcakton objektiva primare dhe masa specifike që duhet të zbatohen nga vendet anëtare përsa vijon:

- Fusha e Veprimit Nr. 1: Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike
- Fusha e Veprimit Nr. 2: Pjesëmarrja në jetën kulturore
- Fusha e Veprimit Nr. 3: Informimi dhe komunikimi
- Fusha e Veprimit Nr. 4: Arsimimi
- Fusha e Veprimit Nr. 5: Punësimi, orientimi dhe formimi profesional
- Fusha e Veprimit Nr. 6: Përshtatshmëria Ndërtimore
- Fusha e Veprimit Nr. 7: Transporti
- Fusha e Veprimit Nr. 8: Jetesa në komunitet
- Fusha e Veprimit Nr. 9: Kujdesi shëndetësor
- Fusha e Veprimit Nr. 10: Rehabilitimi
- Fusha e Veprimit Nr. 11: Mbrojtja sociale
- Fusha e Veprimit Nr. 12: Mbrojtja ligjore
- Fusha e Veprimit Nr. 13: Mbrojtja kundër dhunës dhe abuzimit
- Fusha e Veprimit Nr. 14: Puna kërkimore dhe zhvillimore
- Fusha e Veprimit Nr. 15: Ndërgjegjësimi

3.1. Fusha e Veprimit Nr.1: Pjesëmarrja në Jetën Politike dhe Publike

3.1.1. Hyrje

Pjesëmarrja e të gjithë qytetarëve në jetën politike, publike dhe në proceset demokratike, është thelbësore për zhvillimin shoqëror. Shoqëria duhet të reflektojë diversitetin e qytetarëve të saj, në mënyrë që të përfitojë nga përvojat dhe njohuritë e tyre. Për këtë arsye, ushtrimi i të drejtës së votës nga ana e personave me aftësi të kufizuara merr rëndësi thelbësore.

Në këtë kuadër, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të krijuar mjedisin ku personave me aftësi të kufizuara u jepet mundësia të marrin pjesë në politikën lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo mund të realizohet vetëm nëse ekzistojnë parakushtet të cilët mundësojnë një pjesëmarrje të vërtetë politike të personave me aftësi të kufizuara.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet faktit se gratë dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara luajnë një rol krahasimisht të vogël në funksionet përfaqësuese dhe politikbërëse. Ndaj është me shumë rëndësi nxitja e rritjes së rolit të tyre si dhe përfshirjes së tyre në grupet përfaqësuese.

3.1.2. Objektivat

- i. Të promovohet në mënyrë aktive krijimi i një mjedisi në të cilin personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë me të drejta të plota në partitë politike dhe shoqërinë civile;

- ii. Të rritet pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, në mënyrë që të përfaqësohet në mënyrë të plotë diversiteti i shoqërisë;
- iii. Të punohet drejt rritjes së pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve me aftësi të kufizuara dhe rritjes së pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara me nevoja të veçanta në të gjitha nivelet e arenës politike;
- iv. Të punohet drejt përfshirjes më të madhe të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese në mënyrë që të rritet roli i tyre në përcaktimin e politikave mbi aftësinë e kufizuar.

3.1.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

- i. Të garantohet përshtatshmëria e procedurave dhe mjediseve të votimit për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre demokratike dhe të mundësohet, aty ku është e mundur, asistenca për të votuar;
- ii. Të mbrohet e drejta e votës së fshehtë e personave me aftësi të kufizuara dhe nëse është e nevojshme, të plotësohet kërkesa e tyre për asistencë në votim nga ana e një personi të zgjedhur prej tyre;
- iii. Të garantohet se asnjë person me aftësi të kufizuara s'do të përjashtohet nga e drejta për të votuar apo për të kandiduar në zgjedhje për shkak të aftësisë së kufizuar të tij / saj;
- iv. Të garantohet se informacioni zgjedhor është i përdorshëm, i përshtatur në të gjitha formatet alternative dhe i kuptueshëm për personat me aftësi të kufizuara;
- v. Të nxiten partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile që të organizojnë takimet e tyre publike dhe ta përçojnë informacionin në një mënyrë të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara;
- vi. Të nxiten personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, të krijojnë dhe të anëtarësohen në organizata përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara në nivel lokal, rajonal apo kombëtar, me qëllim që të kontribuojnë dhe ndikojnë në vendimmarrje në të gjitha nivelet;
- vii. Të mbështetet konsultimi me personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre në procesin e vendimmarrjes demokratike në kuadrin e shanseve të barabarta për të gjithë;
- viii. Të zbatohen dispozitat e rekomandimeve Rec (2001)19 të Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike në nivel lokal, Rec (2003)3 të Komitetit të Ministrave për vendet anëtare për pjesëmarrje të balancuar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike, Rec (2004)11 mbi standardet ligjore, operationale dhe standardet teknike të votimit elektronik, si dhe Rec(2004)15 mbi qeverisjen elektronike.

3.2. Fusha e Veprimit Nr. 2: Pjesëmarrja në jetën kulturore

3.2.1. Hyrje

E drejta e personave me aftësi të kufizuara për tu integruar plotësisht si individë në shoqëri varet edhe nga pjesëmarrja e tyre në jetën kulturore të kësaj shoqërie. Të gjithë personat, me aftësi të kufizuara ose jo, duhet të jenë në gjendje të jetojnë në mënyrë sa më të plotë që të jetë e mundur, duke patur të drejtën e ndërveprimit në shoqëri. Të gjithë njerëzit kanë të drejtën e pjesëmarrjes në kulturë, aktivitete argëtuese, sport dhe turizëm.

Këshilli i Evropës dhe vendet e tij anëtare angazhohen që të mbajnë parasysh të drejtat e personave me aftësi të kufizuara përgjatë formulimit dhe zbatimit të politikave të tyre kulturore. Del e nevojshme

marrja e masave të bashkërenduara për të përmirësuar mundësitë dhe cilësinë e jetesës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet rritjes së përfshirjes së tyre në art dhe në jetën shoqërore.

Arritja e këtyre synimeve nuk është e lehtë. Edhe pse mund të ndiqen rrugë të ndryshme për të patur suksese në këtë drejtim, mund të dalë i nevojshëm miratimi i legjislacionit specifik. Kjo përjasje duhet të pasqyrojë konceptin e “përmirësimit të arsyeshëm”, veçanërisht në kontekstin e ndërtesave të vjetra, monumenteve historikë apo ndërtesave të përmasave të vogla të biznesit privat. Gjithashtu, kjo përjasje kërkon reflektimin sa më të plotë të diversitetit të shoqërisë në median elektronike.

3.2.2. *Objektivat*

- i. Të merren masat e nevojshme që personave me aftësi të kufizuara t’u garantohet mundësia e pjesëmarrjes në jetën kulturore në nivel lokal, rajonal, dhe kombëtar;
- ii. Personave me aftësi të kufizuara tu garantohet mundësia e pjesëmarrjes në aktivitete kulturore, çlodhëse, argëtuese, sportive, shpirtërore dhe sociale, si në rolin e vëzhguesit, ashtu edhe në rolin e pjesëmarrësit;
- iii. Personave me aftësi të kufizuara t’u garantohet mundësia e zhvillimit dhe përdorimit të potencialeve të tyre krijuese, atletike, artistike, shpirtërore dhe intelektuale për të mirën e tyre dhe të komuniteteve të tyre.

3.2.3. *Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare*

- i. Të nxiten institucionet dhe autoritetet përkatëse në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar për përshtatjen e literaturës dhe informacioneve kulturore në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, duke përdorur aty ku është e mundur teknologjinë elektronike, në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme;
- ii. Tu kërkohet institucioneve përkatëse publike dhe të nxiten institucionet private, autoritetet shtetërore dhe operatorët privatë, të përfshijnë në mënyrë aktive të gjithë personat me aftësi të kufizuara në aktivitetet e tyre kulturore, argëtuese, sportive, shpirtërore dhe intelektuale;
- iii. Të nxiten mediat elektronike dhe industritë mediatike që të garantojnë mundësinë e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në media, filma, teatro dhe aktivitete të tjera artistike nëpërmjet përdorimit të formateve të përshtatshme për ta, të cilët mund të përfshijnë përdorimin e përshkrimeve të imazheve me tekst të shkruar, përdorimin e titrave, përshkrimeve të imazheve me fjalë, si dhe përdorimin e gjuhës së shenjave;
- iv. Tu kërkohet mediave elektronike kombëtare dhe industrive mediatike të hartojnë dhe publikojnë plane veprimi për rritjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, si “përballë kamerave/mikrofonave, ashtu edhe pas tyre”;
- v. Të nxiten institucionet dhe organizmat përkatës që merren me kulturë, sport, argëtim dhe turizëm, që të ndërmarrin në mënyrë të rregullt trajnime ndërgjegjësimi për personelin lidhur me aftësinë e kufizuar, në mënyrë që ky dimension të integrohet në aktivitetin e tyre;

- vi. Të mundësohet pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në kulturë, sport, turizëm dhe aktivitete argëtuese duke nxitur operatorët përkatës të përshtasin mjediset e tyre me të gjitha mjetet e nevojshme;
- vii. Të ndërmerren veprimet përsa vijon:
 - Të merren masa që ligjet që mbrojnë pronësinë intelektuale të mos përbëjnë një barrierë të panevojshme apo diskriminuese për përdorimin e materialeve kulturore nga ana e personave me aftësi të kufizuara, në respekt të plotë të dispozitave të ligjit ndërkombëtar;
 - Tu mundësohet personave me aftësi të kufizuara që të marrin statusin e artistit dhe të përfitojnë nga pronësia e veprës së tyre artistike;
- viii. Të nxiten personat me aftësi të kufizuara që të marrin pjesë në çfarëdo aktiviteti, pavarësisht nëse këto aktivitete u drejtohen atyre apo jo;
- ix. Të merren masa që sporti dhe aktivitetet kulturore të jenë pjesë përbërëse e programeve të edukimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke njohur rolin e këtyre aktiviteteve në rritjen e aftësive sociale.

3.3. Fusha e Veprimit Nr. 3: Informimi dhe Komunikimi

3.3.1. Hyrje

Përdorimi pa pengesa i informacionit dhe komunikimit përbën një parakusht për pjesëmarrjen në shoqëri. Nëse synojmë që personave me aftësi të kufizuara t'u mundësohet ushtrimi i lirshëm i të drejtave të pjesëmarrjes dhe i vendimmarrjes mbi jetën e tyre, ka rëndësi të dorës së parë që atyre tu mundësohet përdorimi pa pengesa i informacionit nëpërmjet sistemeve të përshtatura të komunikimit. Por megjithatë, edhe në ditët e sotme, shumë personave me aftësi të kufizuara u mungojnë mundësitë e përdorimit të informacionit dhe të mjeteve të komunikimit.

Zhvillimet e vazhdueshme në fushën e informacionit dhe komunikimit po ndryshojnë mënyrën e ndërveprimit midis njerëzve. Ndryshimi ka prekur mënyrën e bërjes së biznesit, përdorimit të shërbimeve, si dhe vetë mënyrën e komunikimit. Ndër zhvillimet kryesore vlen të përmendet interneti, komunikimi elektronik, videofonët, etj. Në këto kushte, merr rëndësi të madhe përfshirja e të gjithë qytetarëve në këto zhvillime teknologjike, në mënyrë që asnjë grup të mos të përjashtohet, veçanërisht personat me aftësi të kufizuara.

Organizmat publikë mbajnë përgjegjësinë e veçantë lidhur me garantimin e përshtatjes së informacionit nëpërmjet një sërë formatesh të ndryshme në përputhje me nevojat e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara. Këto organizma publikë duhet të shërbejnë si modele praktikash të mira për sektorin privat. Gjithashtu, këto praktika të mira duhet të ndiqen nga të gjitha organizmat që ofrojnë shërbime për persona me aftësi të kufizuara.

Sistemet e komunikimit duhet të përshtaten në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Tashmë ekzistojnë shembuj mjaft të mirë të sistemeve që mund të përdoren, si përshebull sisteme të telefonave rele, apo sisteme të komunikimit me video apo tekst.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të konsultohen lidhur me zhvillimin e standardeve për projektimin dhe krijimin e sistemeve të reja të komunikimit dhe informimit.

Personave me aftësi të kufizuara duhet tu mundësohet përdorimi i sistemeve të informimit dhe komunikimit ashtu si çdo personi tjetër, në mënyrë që të garantohet funksionimi i një shoqërie vërtet gjithëpërfshirëse.

3.3.2. *Objektivat*

- i. Të ndërmerren hapat e nevojshëm që personave me aftësi të kufizuara tu garantohet mundësia për të kërkuar, dhënë dhe marrë informacion në mënyrë të barabartë me anëtarët e tjerë të shoqërisë;
- ii. Të përdoren në mënyrën më efektive të mundshme teknologjitë e reja me qëllim rritjen e pavarësisë dhe ndërveprimit të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e jetës.

3.3.3. *Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare*

- i. Të mundësohet dhënia e informacionit zyrtar për personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet përdorimit të formateve të përshtatura, duke marrë në konsideratë nevojat e veçanta që lindin nga tipet e ndryshme të aftësisë së kufizuar (ku përfshihet gjuha Braille, librat folës, apo tekstet e përshtatura);
- ii. Të mundësohet trajnimi dhe çfarëdo aktiviteti tjetër që synon përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga personat me aftësi të kufizuara;
- iii. Të garantohet përdorimi i materialeve mësimdhënës elektronikë nga ana e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me standardet ekzistuese të përshtatshmërisë;
- iv. Të njihet e drejta e personave me aftësi të kufizuara për përdorimin e gjuhës së shenjave, gjuhës Braille dhe mjeteve alternative të komunikimit (përfshirë shërbimet e advokimit), dhe të integrohen këto mjete alternative komunikimi me sa të jetë e mundur në komunikimin zyrtar. Nëse kërkohet, duhet të mundësohet përmbledhja e përmbajtjes së konferencave dhe takimeve në mënyrë të kuptueshme nga personat me aftësi të kufizuara.
- v. Të përshtaten sistemet e komunikimit në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja, përshtetja nëpërmjet komunikimit tekstual;
- vi. Të garantohet përshtatja e informimit dhe e komunikimit zyrtar të autoriteteve dhe organizmave publikë me nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Faqet e internetit të këtyre autoriteteve dhe organizmave duhet të përputhen me standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare mbi përshtatshmërinë;
- vii. Të nxiten të gjithë organizmat publikë, veçanërisht ato organizma që financohen me fonde publike, që të përshtasin informacionin dhe komunikimin e tyre me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.
- viii. Të nxitet zhvillimi, prodhimi dhe shpërndarja e teknologjive me kosto të ulët për përshtatjen e informacionit dhe komunikimit në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

ix. Të promovohet arritja e parimeve të projektimit universal përsa i përket të gjitha zhvillimeve të teknologjisë së komunikimit;

x. Të zbatohet rezoluta (ResAp(2001)3 “Drejt integritit të plotë të personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja gjithëpërfshirëse”.

3.4. Fusha e Veprimit Nr. 4: Arsimimi

3.4.1. Hyrje

Arsimimi është një faktor thelbësor për garantimin e përfshirjes sociale dhe pavarësisë së të gjithë personave përfshirë ata me aftësi të kufizuara. Ndikimi social i familjes dhe shokëve luajnë një rol të rëndësishëm në këtë aspekt. Nga ana tjetër, kjo fushë veprimi e konsideron arsimimin, krahas rolit të familjes, si një faktor që shtrihet në të gjitha fazat e jetës, duke përfshirë arsimin parashkollor, fillor, tetëvjeçar, të mesëm, universitar, profesional si dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Krijimi i mundësive të pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor u shërben jo vetëm personave me aftësi të kufizuara por edhe personave pa aftësi të kufizuara, të cilët në këtë mënyrë përmirësojnë të kuptuarit e diversitetit njerëzor. Pjesa më e madhe e sistemeve arsimore mundësojnë përfshirjen në arsimin e përgjithshëm dhe në strukturat e arsimit special për personat me aftësi të kufizuara. Strukturat e arsimit të përgjithshëm dhe atij special duhet të nxiten të bashkërendojnë punën e tyre për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara brenda komuniteteve të tyre, gjithnjë në përputhje me qëllimin e arritjes së përfshirjes së plotë.

3.4.2. Objektivat

i. Të gjithë personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga natyra dhe shkalla e kufizimit të tyre, duhet t'u garantohen mundësi të barabarta për arsimimin, si dhe për zhvillimin e potencialit të plotë të personalitetit, talentit, kreativitetit dhe aftësive të tyre intelektuale dhe fizike.

ii. Personave me aftësi të kufizuara duhet tu jepet mundësia e pjesëmarrjes në arsimin e përgjithshëm duke nxitur autoritetet përkatëse të zhvillojnë skema arsimimi që plotësojnë nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara;

iii. Të mbështetet dhe promovohet të mësuarit gjatë të gjithë jetës për personat me aftësi të kufizuara të të gjitha moshave dhe të mundësohet një kalim efektiv dhe efikas midis fazave të ndryshme të arsimimit si dhe midis arsimimit dhe punësimit;

iv. Në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit, përfshirë këtu edhe arsimin për fëmijët e moshës së hershme, të promovohet respekti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

3.4.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

i. Të promovohet legjisllacioni, politikat dhe planifikimi i masave për shmangjen e diskriminimit ndaj fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara në të gjitha fazat e arsimimit, duke filluar që nga fëmijëria e hershme. Për arritjen e këtij qëllimi duhet të konsultohen vetë personat me aftësi të

kufizuara, si dhe prindërit, kujdestarët, organizatat vullnetare, dhe të gjitha organizatat përkatëse profesionale;

ii. Të inkurajohet dhe mbështetet zhvillimi i një sistemi të unifikuar arsimor, i cili të përfshijë arsimin e përgjithshëm dhe atë special, i cili të promovojë shkëmbimin e eksperiencave dhe përfshirjen sa më të madhe në komunitet të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të rinjve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara;

iii. Të mundësohet vlerësimi sa më i hershëm dhe i plotë i nevojave të veçanta për arsimim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të rinjve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara, në mënyrë që arsimimi i tyre të planifikohet të dhe realizohet në mënyrë adekuate.

iv. Të monitorohet zbatimi i planeve arsimore individuale dhe të mbështetet një përfaqje e bashkërenduar drejt arsimimit me synim punësimin;

v. Tu jepet mbështetja e nevojshme personave me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe fëmijët, në kuadër të sistemit të përgjithshëm arsimor, për të mundësuar arsimimin efektiv të tyre. Në raste të veçanta, nëse nevojat e tyre për arsimim special nuk përmbushen nga sistemi i arsimit të përgjithshëm, vendet anëtare duhet të garantojnë marrjen e masave speciale alternative në përputhje me objektivin e përfshirjes së plotë. Të gjitha dispozitat për arsimin e përgjithshëm dhe special duhet të nxisin kalimin drejt arsimit të përgjithshëm, si dhe të reflektojnë të njëjtat qëllime dhe standarde.

vi. Të nxitet dhënia e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për të gjithë profesionistët e sistemit arsimor në të gjitha nivelet e arsimit, për ndërgjegjësimin lidhur me aftësinë e kufizuar si dhe përdorimin e teknikave dhe materialeve didaktikë adekuate në mbështetje të nxënësve dhe studentëve me aftësi të kufizuara atje ku është e nevojshme;

vii. Të garantohet mundësia e përdorimit të të gjitha materialeve didaktike dhe skemave të sistemit të arsimit të përgjithshëm nga ana e personave me aftësi të kufizuara;

viii. Të përfshihen të drejtat qytetare të personave me aftësi të kufizuara në kuadër të shanseve të barabarta, në kurrikulat shkollore të edukimit qytetar;

ix. Të garantohet përfshirja e ndërgjegjësimit lidhur me të drejtat e aftësisë së kufizuar në programet arsimore të shkollave dhe institucioneve që bëjnë pjesë në arsimin e përgjithshëm;

x. Të merren hapa për garantimin e përshtatshmërisë ndërtimore të të gjitha institucioneve arsimore, përfshirë dhënien e mbështetjes personale dhe realizimin e punimeve dhe sjelljen e instrumenteve për garantimin e kësaj përshtatshmërie;

xi. Të mundësohet pjesëmarrja aktive e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin e hartimit të planeve arsimore individuale të fëmijëve të tyre;

xii. Të garantohet pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në arsimin joformal, duke u mundësuar të rinjve me aftësi të kufizuara përvetësimin e aftësive të cilat nuk mund të përvetësohen nëpërmjet arsimit formal;

xiii. Të merret në konsideratë, sipas rastit, nënshkrimi dhe ratifikimi i Kartës Sociale Evropiane (të rishikuar) (ETS Nr.163), veçanërisht neni 15.

3.5. Fusha e veprimit Nr. 5: Punësimi, orientimi në trajnimin dhe kualifikimin profesional

3.5.1. Hyrje

Punësimi është një element kyç për përfshirjen sociale dhe pavarësinë ekonomike të të gjithë qytetarëve në moshë pune. Në krahasim me personat pa aftësi të kufizuara, punësimi dhe shkalla e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës është shumë e ulët. Ndaj është i nevojshëm diversifikimi i politikave për rritjen e kësaj pjesëmarrjeje, në përputhje me potencialin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Ky diversifikim duhet të kryhet në kuadër të një përqsasjeje tërësore, në mënyrë që të adresohen të gjitha pengesat për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në kontigjentin e të punësuarve. Përmirësimi i situatës së punësimit të personave me aftësi të kufizuara nuk u shërben vetëm personave me aftësi të kufizuara por edhe punëdhënësve si dhe shoqërisë në përgjithësi.

Orientimi dhe asistenca për kualifikimin profesional luajnë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar personat në nevojë në identifikimin e atyre fushave të punësimit ku mund të kontribuojnë më së miri. Në këtë aspekt, rëndësi të veçantë ka identifikimi i nevojave të trajnimit për të mundësuar kualifikimin për punësimin e ardhshëm. Për këtë arsye, personave me aftësi të kufizuara duhet tu jepet mundësia që të përfitojnë nga vlerësimet, kualifikimet dhe trajnimet profesionale, të cilat u mundësojnë atyre të përmbushin potencialet e tyre në tregun e punës.

Kjo fushë veprimi ka për synim krijimin e një baze të zgjeruar pjesëmarrjeje për personat me aftësi të kufizuara në sferën e punësimit si dhe mundësimin e tyre për të bërë karrierë nëpërmjet krijimit të strukturave mbështetëse të cilat mbështesin zgjedhjet reale të tyre. Të gjitha masat e kësaj fushe veprimi duhet të zbatohen si ndaj të punësuarve në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Ndërmarrjet sociale (përshebull kompanitë sociale, kooperativat sociale) apo skema të tjera si fabrikat sociale mund të kontribuojnë në punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

3.5.2. Objektivat

i. Të promovohet punësimi i personave me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës nëpërmjet kombinimit të masave antidiskriminuese me veprimin pozitiv për garantimin e shanseve të barabarta për personat me aftësi të kufizuara;

ii. Të evitohet diskriminimi dhe të promovohet pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në orientimin, udhëzimin, trajnimin, kualifikimin profesional apo në aktivitetet e tjera mbështetëse të fushës së punësimit.

3.5.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

i. Të integrohet punësimi i personave me aftësi të kufizuara në politikat e përgjithshme të punësimit;

- ii. Personave me aftësi të kufizuara tu mundësohet një vlerësim objektiv dhe individual, i cili:
 - Identifikon shanset e tyre përkundrejt punësimit të tyre të mundshëm;
 - Zhvendos fokusin nga vlerësimi i aftësisë së kufizuar në vlerësimin e aftësive të personave me aftësi të kufizuara përkundrejt kërkesave specifike të punësimit;
 - Krijon bazën për programin e kualifikimit profesional;
 - Mbështet personat me aftësi të kufizuara për të gjetur punësim apo ripunësim të përshtatshëm;
- iii. Personave me aftësi të kufizuara tu mundësohet orientimi profesional, trajnimi, kualifikimi dhe shërbimet e punësimit si dhe tu jepen mundësitë më të mira të kualifikimit, duke i përshtatur ato aty ku është e nevojshme;
- iv. Të merren masa për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga diskriminimi në të gjitha fazat e punësimit, përfshirë këtu përzgjedhjen dhe rekrutimin si dhe në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me përparimin në karrierë;
- v. Të nxiten punëdhënësit që të marrin në punë personat me aftësi të kufizuara duke:
 - Zbatuar procedurë punësimi (duke përfshirë shpalljen e vendeve të lira të punës, intervistimin, vlerësimin, përzgjedhjen) të cilat përfshijnë mundësinë e punësimit për personat me aftësi të kufizuara;
 - Përshtatur në mënyrë të arsyeshme vendin dhe kushtet e punës, duke përfshirë përdorimin e telekomunikimit, punës me orar të reduktuar, si dhe punës nga shtëpia, për t'iu përshtatur kërkesave të veçanta të të punësuarve me aftësi të kufizuara;
 - Rritur ndërgjegjësimin lidhur me aftësinë e kufizuar të menaxherëve dhe personelit nëpërmjet dhënies së trajnimit përkatës;
- vi. Të mundësohet funksionimi i skemave të përgjithshme të vetpunësimit, të cilat të mbështesin personat me aftësi të kufizuara;
- vii. Të mundësohet dhënia e masave mbështetëse për punësimin e subvencionuar apo të mbështetur nga shteti për ata persona me aftësi të kufizuara, nevojat e të cilëve nuk mund të plotësohen në tregun e lirë të punës në mungesë të mbështetjes personale;
- viii. T'u jepen personave me aftësi të kufizuara mundësia e përparimit nga punësimi i subvencionuar drejt punësimit në tregun e hapur të punës;
- ix. Të hiqen pengesat ndaj punësimit të personave me aftësi të kufizuar, të cilat përmbahen në skemën e pagesave për aftësinë e kufizuar dhe t'i nxisë ata të punojnë sapo t'u jepet mundësia;
- x. Të merren në konsideratë nevojat e grave me aftësi të kufizuara përgjatë hartimit të programeve dhe politikave të shanseve të barabarta për punësimin e grave, përfshirë edhe kujdesin për fëmijët;
- xi. Të garantohen të njëjtat të drejta midis punonjësve me aftësi të kufizuara dhe punonjësve të tjerë lidhur me konsultimet për kushtet e punësimit, si dhe anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aktive në sindikata;
- xii. Të merren masa efektive për të nxitur punësimin e personave me aftësi të kufizuara;

xiii. Të përfshihen nevojat e personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin shëndetësor dhe atë të sigurimeve, në mënyrë që të eliminohet çdo diskriminim ndaj tyre;

xiv. Të promovohet marrja e masave, përfshirë këtu masat legjislative dhe menaxheriale, të cilat t'u mundësojnë ruajtjen e qasjes në tregun e punësimit atyre personave që pësojnë aftësi të kufizuara në vendin e punës, apo përgjatë periudhës së punësimit;

xv. Të mundësohet përfshirja e të rinjve me aftësi të kufizuara në stazhet e punësimit dhe trajnimet profesionale në mënyrë që të krijojnë aftësi dhe të mbledhin informacion lidhur me praktikën e punësimit;

xvi. Të merret në konsideratë, sipas rastit, nënshkrimi dhe ratifikimi i Kartës Sociale Evropiane (të rishikuar) (ETS Nr.163), veçanërisht neni 15.

xvii. Të zbatohet Rezoluta ResAP (95)3 mbi Kartën e Vlerësimit Profesional të Personave me Aftësi të Kufizuara.

3.6. Fusha e Veprimit Nr. 6: Përshtatshmëria Ndërtimore

3.6.1. Hyrje

Qëllimi kryesor është krijimi i një shoqërie për të gjithë. Një mjedis i përshtatur është shumë i rëndësishëm për krijimin e një shoqërie përfshirëse, e cila u mundëson personave me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në jetën e përditshme. Barrierat ekzistuese në mjedisin ndërtimor pengojnë dhe përjashtojnë personat me aftësi të kufizuara nga pjesëmarrja e tyre në shoqëri dhe nga gëzimi i të drejtave thelbësore të njeriut. Përshtatshmëria ndërtimore, i sjell përparësi jo vetëm komunitetit të personave me aftësi të kufizuara por edhe shoqërisë në tërësinë e saj. Arritja e përshtatshmërisë ndërtimore ka si parakusht të kuptuarit e pengesave ekzistuese si fizike ashtu edhe mendore. Vetëm të kuptuarit e këtyre barrierave mundëson angazhimin për kapërcimin e tyre nëpërmjet veprimit pozitiv dhe masave të tjera. Rezoluta ResAP(2000)1 mbi projektimin universal promovon përdorimin e parimit të projektimit universal në kurrikulat e të gjitha disiplinave të ndërtimit, ku përfshihen kurrikulat e arkitekturës, inxhinjerisë, planifikimit urban si dhe të gjitha profesioneve të tjera të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin. Ndër të tjerat, kjo rezolutë ka si synim thjeshtimin e jetës për çdo njeri nëpërmjet krijimit të një mjedisi më të përdorshëm, të përshtatshëm dhe të kuptueshëm.

3.6.2. Objektivi

Krijimi gradual i një mjedisi të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet zbatimit të projektimit universal, duke shmangur krijimin e barrierave të reja.

3.6.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

i. Të garantohet integrimi i qëllimit për krijimin e një mjedisi pa barriera në të gjitha fushat e politikbërjes;

- ii. Të hartohen udhëzimet, standardet dhe nëse është e nevojshme, legjislacioni i nevojshëm, për promovimin e mjediseve ndërtimore pa barriera, të cilat përfshijnë ndërtesat publike, hapësirat publike të brendshme dhe të jashtme, të cilat të përdoren pa pengesa nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara, duke mbajtur në konsideratë natyrën specifike të ndërtesave historike.
- iii. Universitetet dhe institucionet përgjegjëse për arsimimin dhe trajnimin e të gjitha disiplinave ndërtimore (arkitektët, urbanistët, profesionistët në sektorin e ndërtimit, ruajtësit e trashëgimisë kulturore dhe specialistët e turizmit kulturor) duhet të promovojnë parimin e projektimit universal nëpërmjet përfshirjes së tij në kurrikulat për trajnimin fillestar dhe të vazhduar, apo në mënyra të tjera.
- iv. Të promovohet përdorimi i mjeteve ndihmëse dhe risive teknologjike në përmirësimin e përshtatshmërisë ndërtimore dhe për krijimin e shanseve të barabarta për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën e komunitetit. Këto praktika duhet të përdoren në të gjitha konstruksionet e reja dhe të shtrihen në mënyrë progresive në ndërtesat ekzistuese;
- v. Të mbështetet krijimi, përcaktimi dhe funksionimi i qendrave që promovojnë konceptin e projektimit universal;
- vi. Të tregohet kujdes për sigurinë e personave me aftësi të kufizuara në hartimin e procedurave të evakuimit dhe emergjencës;
- vii. Të garantohet hyrja e kafshëve ndihmëse të personave me aftësi të kufizuara në ndërtesat dhe hapësirat publike;
- viii. Të zbatohet Rezoluta ResAp (2001)1 mbi përdorimin e parimeve të projektimit universal në kurrikulat arsimore të të gjitha profesioneve që kanë të bëjnë me ndërtimin.

3.7. Fusha e Veprimit Nr. 7: Transporti

3.7.1. Hyrje

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave për përshtatjen e sistemeve të transportit në të gjitha nivelet mund të sjellë përmirësime të ndjeshme në cilësinë e jetesës së shumë personave me aftësi të kufizuara dhe mund të konsiderohet si parakusht për realizimin e shanseve të barabarta, jetesës së pavarur dhe pjesëmarrjes aktive të personave me aftësi të kufizuara në jetën sociale dhe kulturore si dhe në sferën e punësimit.

Shumë vende anëtare të Këshillit të Evropës janë në dijeni ose pjesëmarrës të zhvillimeve të iniciuara nëpërmjet Konferencës Evropiane të Ministrave të Transportit (ECMT) si dhe të parimeve të promovuara nëpërmjet këtij forumi. Këto zhvillime mund të orientojnë edhe punën e vendeve të tjera anëtare në zbatimin e këtij planveprimi. Shërbimet e përshtatura të transporteve që vijnë si rrjedhojë nga këto politika sjellin përfitime të mëdha jo vetëm për personat me aftësi të kufizuara por edhe për përdorues të tjerë të shërbimeve të transportit, përfshirë këtu të moshuarit dhe prindërit me fëmijë të vegjël.

Përshtatja efektive e sistemit të transportit publik për nevojat e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara kërkon marrjen e masave për sigurimin e përshtatshmërisë në të gjithë zinxhirin e sistemit të transportit.

3.7.2. Objektivat

- i. Të përmirësohet pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri nëpërmjet zbatimit të politikave për përshtatjen e sistemit të transportit;
- ii. Të garantohet marrja në konsideratë e nevojave të të gjithë personave me aftësi të kufizuara të të gjitha llojeve në hartimin dhe zbatimin e politikave për përshtatjen e sistemit të transportit;
- iii. Të promovohet përshtatshmëria e shërbimeve ekzistuese për transportin e pasagjerëve për të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe të mundësohet përshtatshmëria e të gjitha shërbimeve të reja të transportit të pasagjerëve dhe përshtatshmëria e infrastrukturës së tyre;
- iv. Të promovohet zbatimi i parimit të projektimit universal në sektorin e transportit.

3.7.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

- i. Të merren parasysh rekomandimet, raportet, udhëzimet e hartuara dhe miratuara nga organizmat ndërkombëtare, veçanërisht lidhur me hartimin e standardeve, udhëzimeve, strategjive dhe nëse është e nevojshme edhe legjislacionit në funksion të përshtatjes së shërbimeve dhe infrastrukturës së transportit, përfshirë këtu edhe përshtatshmërinë ndërtimore;
- ii. Të monitorohet dhe rishikohet zbatimi i politikave për përshtatshmërinë e transportit;
- iii. Të nxiten operatorët e transportit publik për përfshirjen e trajnimit të detyrueshëm në kurset standarde të trajnimit për personat e punësuar në shërbimin e transportit publik;

- iv. Të promovohet hartimi i direktivave kombëtare për përshtatjen e shërbimeve të transportit, të cilat duhet të zbatohen si nga operatorët publikë, ashtu edhe nga operatorët privatë të transporteve;
- v. Të krijohen procedura për bashkërendimin dhe konsultimin e këtyre politikave me palët e interesuara, me institucionet përkatëse qeveritare, operatorët e shërbimeve dhe grupet e interesit të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që të garantohet informimi i palëve lidhur me procesin e politikbërjes dhe planifikimit të politikave të përshtatshme të transportit;
- vi. Të promovohen dhe të nxiten operatorët privatë të shërbimeve të transportit për ofrimin e shërbimeve të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara;
- vii. Të garantohet dhënia e informacionit për shërbimet e transportit publik në formate të ndryshme dhe nëpërmjet sistemeve të ndryshme të komunikimit në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara në masën më të madhe që të jetë e mundur;
- viii. Të nxitet projektimi i programeve inovative në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara që hasin vështirësi në përdorimin e mjeteve të transportit publik, në mënyrë që ata të mund të përdorin në mënyrë individuale mjete të përshtatura transporti në pronësinë e tyre private;
- ix. Të mundësohet akomodimi i kafshëve ndihmëse (përshembull qenve) të cilat shoqërojnë personat me aftësi të kufizuara në mjetet e transportit publik;
- x. Të mundësohet krijimi dhe ruajtja e hapësirave të parkimit për personat me aftësi të kufizuara motore;
- xi. Të merren në konsideratë nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara përgjatë hartimit të direktivave të përgjithshme mbi të drejtat e pasagjerit;
- xii. Personat me aftësi të kufizuara të mbrohen nëpërmjet legjislacionit nga diskriminimi në mjetet e transportit publik;
- xiii. Të garantohet se masat e emergjencës dhe sigurisë së transportit nuk do të krijojnë pabarazi shtesë për personat me aftësi të kufizuara.

3.8. Fusha e veprimit Nr. 8: Jetesa në Komunitet

3.8.1. Hyrje

Kjo fushë veprimi synon t'u mundësojë personave me aftësi të kufizuara një jetesë sa më të pavarur që të jetë e mundur, duke u mundësuar atyre të marrin vendime mbi jetën e tyre. Arritja e këtij qëllimi kërkon hartimin e politikave strategjike, të cilat mbështesin zhvendosjen nga kujdesi institucional drejt përkujdesjes në komunitet, i cili përfshin skemat e jetesës së pavarur dhe jetesës në grupime të vogla shtëpiake. Këto politika duhet të jenë fleksible dhe të përfshijnë programe të cilat u mundësojnë personave me aftësi të kufizuara që të jetojnë në gjirin e familjeve të tyre. Këto programe duhet të marrin në konsideratë nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara të cilët kanë nevojë për përkujdesje të llojit të veçantë.

Në përgjithësi, jeta e përditshme e një familjeje ndryshohet në mënyrë të konsiderueshme nga prania e një fëmije me aftësi të kufizuara: kujdesi për këtë fëmijë kërkon mjaft kohë, përpjekje, organizim vizitash me terapistë, doktorë, etj. Gjithashtu, fëmija me aftësi të kufizuara kërkon mbikqyrje të vazhdueshme si në kohën e lirë ashtu edhe në aspektet praktike të jetës së përditshme. Për këto arsye, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë nevojë për trajnim të veçantë, i cili duhet t'i ndihmojë ata në përvetësimin e aftësive të nevojshme për një jetesë sa më normale që të jetë e mundur në afërsi të fëmijës së tyre me aftësi të kufizuara.

Jetesa tërësisht e pavarur nuk përbën domosdoshmërisht një mundësi zgjidhjeje për të gjithë individët. Në raste të jashtëzakonshme, kujdesi me anën e strukturave të vogla që ofrojnë shërbime të cilësisë së lartë duhet të konsiderohet si një alternativë mjaft e mirë përkundrejt kujdesit shëndetësor që jepet në një institucion rezidencial të tipit tradicional. Është e qartë se personat me aftësi të kufizuara duhet të përfshihen në gjetjen e mënyrave për një jetesë së pavarur.

Personat me aftësi të kufizuara kanë nevoja të ndryshme të cilat kërkojnë nivele të ndryshme përkujdesjeje dhe mbështetjeje. Kjo mbështetje mund të arrihet nëpërmjet zbatimit të kriterëve transparente të përzgjedhjes së skemave të përkujdesjes si dhe nëpërmjet procedurave të pavarura të vlerësimit individual të cilat marrin parasysh zgjedhjet e vetë personave me aftësi të kufizuara si dhe interesin e tyre për mundësi të barabarta në përdorimin e shërbimeve.

Politikat për jetesën e pavarur nuk duhet të kufizohen tek mënyrat e jetesës të para në një këndvështrim të ngushtë, por varen nga mundësia e përdorimit të një spektri të gjerë shërbimesh, përfshirë këtu edhe shërbimet e transportit. Suksesi i këtyre politikave kërkon një përjasje tërësore për planifikimin, zhvillimin dhe dhënien e shërbimeve të integruara, në mënyrë që nevojat e individëve me aftësi të kufizuara të plotësohen nëpërmjet një përpjekjeje që kërkon bashkërendim ndër-institucional dhe përjasje multidisiplinore.

3.8.2. Objektivat

- i. Personave me aftësi të kufizuara t'u jepet mundësia ta planifikojnë vetë jetën e tyre dhe të jetojnë në mënyrë sa më të pavarur që të jetë e mundur në gjirin e komunitetit të tyre;
- ii. Të mundësohet dhënia e një spektri të gjerë shërbimesh cilësore në nivel komunitar, në mënyrë që t'i lihet hapësirë lirisë së zgjedhjes;
- iii. T'i kushtohet vëmendje e veçantë situatës së familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara dhe të promovohet një përjasje, e cila mundëson trajnimin e prindërve, si dhe përfshirjen e tyre në edukimin dhe përkujdesjen e fëmijëve.

3.8.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

- i. Të mundësohet një përjasje e bashkërenduar për dhënien e shërbimeve mbështetëse cilësore në komunitet, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të mund të jetojnë në komunitet dhe të përmirësojnë cilësinë e jetesës;
- ii. Të zhvillohen dhe promovohen politika të cilat u mundësojnë personave me aftësi të kufizuara të jetojnë në kushte të përshtatshme strehimi në komunitetet e tyre lokale;
- iii. Të mbështetet ndihma formale dhe joformale e cila u mundëson personave me aftësi të kufizuara të jetojnë në shtëpitë e tyre;
- iv. Të njihet statusi i kujdestarisë, t'u mundësohet kujdestarëve mbështetje dhe trajnim;
- v. Të kryhet vlerësimi i nevojave të familjeve të personave me aftësi të kufizuara, duke i konsideruar ato si dhënëse shërbimesh joformale. Të vlerësohen në mënyrë të veçantë nevojat e atyre familjeve të cilat kanë fëmijë me aftësi të kufizuara apo persona me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për nivel të veçantë përkujdesjeje, në mënyrë që këto familje të mbështeten me informacion, trajnim dhe asistencë, përfshirë këtu edhe asistencë psikologjike, duke i kushtuar vëmendje të veçantë lidhjes së jetës private me atë profesionale, si dhe barazisë gjinore;
- vi. Të jepet shërbim cilësor i bazuar në komunitet dhe të ofrohen modele alternative të strehimit, të cilat kalojnë nga kujdesi i bazuar në institucione në kujdesin e bazuar në jetesën në komunitet;
- vii. Të mundësohet vendimmarrja e informuar e individëve me aftësi të kufizuara, me asistencën e shërbimeve profesionale të advokimit aty ku është e nevojshme;
- viii. Të promovohen skema që u mundësojnë personave me aftësi të kufizuara t'i zgjedhin vetë kujdestarët e tyre personalë;
- ix. Të ofrohen shërbime shtesë dhe mjedise të tjera, si përshebull qendra ditore, qendra për trajtim të përkohshëm, apo grupe terapeutike, në mënyrë që personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre tu ofrohen periudha qetësie dhe çlodhjeje;
- x. Personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht atyre që kanë nevojë për trajtim special, tu ofrohet shërbim i personalizuar, përfshirë shërbime të avokatisë, në mënyrë që të zvogëlohet në maksimum rreziku i përjashtimit social;
- xi. Të zbatohen dispozitat përkatëse të përfshira në rekomandimin Nr. R (96) 5 të Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi lidhjen e jetës profesionale me jetën familjare.

3.9. Fusha e veprimit Nr. 9: Kujdesi Shëndetësor

3.9.1. Hyrje

Personat me aftësi të kufizuara kanë të njëjtat të drejta me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë për të përfituar nga shërbimet shëndetësore të cilësisë së lartë, si dhe nga trajtimi mjekësor i teknologjisë së lartë. Në

disa raste, personave me aftësi të kufizuara u nevojitet përkujdesje shëndetësore inovative për përmirësimin e cilësisë së jetës. Për këtë arsye, personat me aftësi të kufizuara dhe aty ku është e nevojshme përfaqësuesit e tyre, duhet të konsultohen dhe përfshihen në proceset vendimmarrëse lidhur me planet e tyre të përkujdesjes individuale. Kjo përqaasje i vendos personat me aftësi të kufizuara në qendër të procesit të planifikimit dhe dhënies së shërbimeve shëndetësore, integruese si dhe u mundëson individëve të marrin vendime të mirëinformuara lidhur me shëndetin e tyre.

Proçesi i planifikimit dhe i dhënies së shërbimeve shëndetësore duhet të marrë në konsideratë zhvillimet që kanë të bëjnë me moshimin e popullatës së personave me aftësi të kufizuara dhe pasojat shëndetësore që mbart ky proces për ta. Për këtë arsye, është e nevojshme t'i jepet prioritet zhvillimit të politikave dhe strategjive në fushën e shëndetit.

Profesionistët e fushës së shëndetësisë në të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës duhet të njihen me modelin social dhe modelin e të drejtave të njeriut përsa u takon personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata mos të fokusohen thjesht dhe vetëm në aspektin mjekësor të aftësisë së kufizuar.

3.9.2. Objektivat

- i. Të gjithë personave me aftësi të kufizuara, pa dallim gjinie, moshe, origjine, lloji apo shkalle të aftësisë së kufizuar t'u garantohet:
 - Mundësi e barabartë përdorimi e të gjitha shërbimeve shëndetësore;
 - Mundësi përdorimi të shërbimeve të specializuara, sipas nevojës;
 - Përfshirje maksimale në procesin e vendimmarrjes mbi planin e tyre personal të përkujdesjes;
- ii. Nevojat e personave me aftësi të kufizuara të përfshihen në fushatat ndërgjegjësuese mbi shëndetin publik, si dhe në arsimimin dhe informacionin mbi shëndetin publik

3.9.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

- i. Personat me aftësi të kufizuara të mos diskriminohen në mundësinë e përdorimit të shërbimeve shëndetësore dhe të librezave shëndetësore;
- ii. Çdo personi me aftësi të kufizuara apo në rast nevoje, çdo përfaqësuesi, kujdestari, apo avokati të tyre, duhet t'i garantohet pjesëmarrja maksimale në vlerësimin, përgatitjen dhe zbatimin e planit të përkujdesjes shëndetësore, ndërhyrjen mjekësore, apo trajtimin mjekësor;
- iii. Të punohet drejt përmirësimit të mjediseve të institucioneve shëndetësore publike dhe private, si dhe drejt përmirësimit të pajisjeve mjekësore, në mënyrë që ambientet dhe shërbimet mjekësore, përfshirë këtu edhe ato të shëndetit mendor, shërbimet mbështetëse psikologjike si dhe shërbimet e emergjencës mjekësore, të jenë të pajisura dhe kompetente për plotësimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara;
- iv. Grave me aftësi të kufizuara tu garantohet mundësi e barabartë e përdorimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, përfshirë këtu trajtimin para lindjes, apo këshillimin, trajtimin gjinekologjik dhe planifikimin familjar;

- vi. Të ndërmerren hapat e nevojshëm për dhënien e të gjithë informacionit të nevojshëm lidhur me nevojat individuale për kujdes shëndetësor në një format të kuptueshëm prej personave me aftësi të kufizuara;
- vii. Informacioni lidhur me identifikimin e aftësisë së kufizuar, si në rastin kur ajo vërehet përpara lindjes ose pas një sëmundjeje apo aksidenti, duhet të jepet në një mënyrë që garanton respekt për personin në fjalë dhe për familjen e tij. Në çdo rast duhet të garantohet dhënia e informacionit të qartë dhe mbështetjes së menjëhershme për individin dhe për familjen e tij;
- viii. Të krijohet mundësi për pjesëmarrje në edukimin mjekësor dhe fushatat e shëndetit publik nëpërmjet dhënies së informacionit dhe këshillave për personat me aftësi të kufizuara;
- ix. Të trajnohen profesionistët e kujdesit shëndetësor duke garantuar ndërgjegjësimin e tyre lidhur me çështjet e aftësisë së kufizuar, si dhe përvetësimin e metodave për përmbushjen e nevojave specifike të personave me aftësi të kufizuara;
- x. Të kihet parasysh nevoja për ndërhyrje të hershme dhe të përcaktohen masat efektive për identifikimin, diagnostikimin dhe trajtimin e hershëm të aftësive të kufizuara. Të hartohen udhëzime të qarta lidhur me identifikimin e hershëm të aftësisë së kufizuar si dhe për masat e ndërhyrjes së shpejtë kundër saj;
- xi. Të shihet mundësia e nënshkrimit dhe ratifikimit të Kartës Sociale Evropiane (të rishikuar), veçanërisht nenit 11.

3.10. Fusha e Veprimit Nr. 10: Rehabilitimi

3.10.1. Hyrje

Rekomandimi Nr.R (92) 6 mbi një politikë koherente për personat me aftësi të kufizuara njih faktin se rehabilitimi i personave me aftësi të kufizuara është një përgjegjësi e komunitetit, garanton dinjitet njerëzor dhe eliminon vështirësitë që hasen në një shoqëri e cila konfrontohet me personat me aftësi të kufizuara; për këtë arsye, rehabilitimi konsiderohet si mënyra më e mirë për të arritur integrimin ekonomik dhe social të personave me aftësi të kufizuara, ndaj ai duhet të përfshihet ndër objektivat prioritarë të çdo shoqërie.

Ky rekomandim vë në dukje rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të një politike koherente për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara, politikë e cila duhet të synojë në radhë të parë parandalimin e përkeqësimit të aftësive të kufizuara, lehtësimin e pasojave të saj, shtimin e autonomisë së personave me aftësi të kufizuara, të cilët duhet të shihen para së gjithash si individë që kanë nevojë për pavarësi ekonomike dhe integrim të plotë në shoqëri ashtu si të gjithë anëtarët e tjerë të shoqërisë. Për këtë arsye, programet tërësorë të rehabilitimit duhet të përfshijnë një spektër të gjerë masash të bashkërenduara me njëra-tjetrën të cilat të përfshijnë dhënien e shërbimeve dhe ngritjen e mjediseve të cilat të kontribuojnë në mënyrë të ndjeshme në pavarësinë fizike dhe psikologjike të personave me aftësi të kufizuara.

3.10.2. Objektivat

- i. Të mundësohet arritja e pavarësisë maksimale nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë në gjendje të përmbushin potencialin e tyre të plotë fizik, mendor, shoqëror dhe profesional;
- ii. Të organizohen, fuqizohen dhe shtrihen më tej shërbimet gjithëpërfshirëse të rehabilitimit;
- iii. Të krijohet mundësia e përdorimit të shërbimeve të përgjithshme dhe speciale për personat me aftësi të kufizuara, në funksion të arritjes së integritetit të tyre të plotë me komunitetin dhe shoqërinë;
- iv. Të garantohet në mënyrë të veçantë ndërhyrja e hershme, përqasja multi-disiplinore ndaj aftësisë së kufizuar që nga lindja, duke vazhduar përgjatë të gjitha fazave të jetës, përfshirë mbështetjen dhe orientimin për prindërit.

3.10.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

- i. Të formulohet, zbatohet dhe rishikohet në mënyrë të rregullt politika kombëtare mbi rehabilitimin dhe të garantohet përmirësimi i vazhdueshëm i saj;
- ii. Personave me aftësi të kufizuara, familjeve të tyre dhe organizatave të tyre përfaqësuese t'u garantohet hartimi i programeve tërësore të rehabilitimit si dhe zbatimi dhe vlerësimi i tyre në vazhdimësi;
- iii. Programet e rehabilitimit duhet të mund të përdoren prej personave me aftësi të kufizuara dhe të jenë të përshtatur me nevojat individuale të personit me aftësi të kufizuara; zbatimi i këtyre programeve kërkon miratimin e vetë personit me aftësi të kufizuara dhe / ose përfaqësuesit të tij;
- iv. Të inkurajohet, me sa të jetë e mundur, përdorimi i sistemit të përgjithshëm shëndetësor dhe të garantohet pajisja e plotë e qendrave të specializuara të rehabilitimit. Të krijohen grupe multidisiplinore të specializuara për rehabilitimin;
- v. Të përmirësohen shërbimet e rehabilitimit si dhe shërbimet mbështetëse nëpërmjet vlerësimit individual multidisiplinor i cili duhet të përdorë një përfaqje tërësore;
- vi. Të promovohet bashkëpunimi ndërsektorial, në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar. Të promovohet, veçanërisht bashkëpunimi midis sektorëve të shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe çështjeve sociale. Të mundësohet një menaxhim i integruar i rehabilitimit dhe të garantohen shanset e barabarta për personat me aftësi të kufizuara aty ku shihet e nevojshme;
- vii. Përgjatë arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara të garantohet funksionimi i programeve të rehabilitimit pedagogjik si dhe mundësimi i resurseve të tjera që ndihmojnë këta fëmijë në përmbushjen e plotë të potencialeve të tyre;
- viii. Të përfshihen, si punëdhënësi, të punësuarit ashtu edhe organizatat e tyre, në procesin e rehabilitimit profesional, në mënyrë që personave me aftësi të kufizuara t'u jepet mundësia të rihyjnë në tregun e punës në rastin më të parë;

ix. Të punohet drejt dhënies së programeve të individualizuar për rehabilitimin në komunitet, për individët me aftësi të kufizuara të cilët kanë paraqitur kërkesë për marrjen e këtyre programeve;

x. Të promovohet përdorimi në masë sa më të gjerë të jetë e mundur i pajisjeve ndihmëse si pjesë e masave dhe programeve rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara të cilët kanë paraqitur kërkesë për marrjen e këtyre pajisjeve.

3.11. Fusha e Veprimit Nr. 11: Mbrojtja Sociale

3.11.1 Hyrje

Mbrojtja sociale përfshin sigurimet shoqërore, asistencën sociale si dhe shërbimet sociale, të cilët mbështesin të gjithë personat në nevojë, duke përmirësuar cilësinë e tyre të jetesës. Megjithatë, vërehen raste kur personave me aftësi të kufizuara nuk u mundësohen shanse të barabarta për të përfituar nga sistemet e mbrojtjes sociale, si për shkak të mungesës së direktivave përkatëse, ashtu edhe për shkak të mungesave të përshtatshmërisë së këtyre shërbimeve. Të drejtat sociale të sanksionuara në Kartën Sociale Evropiane (ETS Nr. 163) të rishikuar, përfshijnë para së gjithash të drejtën për sigurime shoqërore (Neni 12), të drejtën për asistencë sociale dhe mjekësore (Neni 13), si dhe të drejtën e përfitimit nga shërbimet e përkujdesjes sociale (Neni 14). Ushtrimi i këtyre të drejtave kontribuon për uljen e riskut të përjashtimit social dhe mundëson realizimin e një të drejte të mëtejshme të sanksionuar në kartën sociale, të drejtës së personave me aftësi të kufizuara për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit (Neni 15).

3.11.2 Objektivat

- i. Të krijohen shanse të barabarta për mbrojtjen sociale të personave me aftësi të kufizuara;
- ii. Të promovohen politikat të cilat punojnë në drejtim të kalimit nga vartësia financiare në pavarësi ekonomike dhe punësim.

3.11.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

- i. Të krijohet një ekuilibër koherent midis masave të mbrojtjes sociale dhe politikave të punësimit aktiv në funksion të shmangjes së varësisë nga përfitimi joaktiv nga pagesat e aftësisë së kufizuar;
- ii. Të garantohet shpërndarja e drejtë e shërbimeve sociale, bazuar në një vlerësim të qenësishëm dhe multidisiplinor të personave me aftësi të kufizuara, vlerësim i cili duhet të rishikohet në mënyrë periodike;
- iii. Të garantohet përshtatshmëria e sistemeve dhe procedurave të skemave të përkujdesjes shoqërore për personat me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e tyre;
- iv. Shërbimi social i përgjithshëm të marrë në konsideratë nevojat specifike, nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe të familjeve të tyre;

- v. Të garantohet bashkërendimi i punës midis institucioneve të linjës dhe operatorëve publikë dhe privatë të shërbimeve sociale, në mënyrë që të arrihet përmirësimi i vazhdueshëm i tyre, në funksion të përmbushjes cilësore të nevojave të personave me aftësi të kufizuara;
- vi. Të mundësohen konsultime të vazhdueshme me partnerët socialë dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm, përfshirë këtu organizatat e personave me aftësi të kufizuara, lidhur me planifikimin dhe zbatimin e politikave të mbrojtjes sociale;
- vii. Të garantohet qarkullimi efektiv i informacionit lidhur me të gjitha përfitimet që ofron sistemi i përkujdesjes sociale, në mënyrë që të shmanget rreziku i përjashtimit social të personave me aftësi të kufizuara;
- viii. Të garantohet përfshirja e nevojave specifike të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha strategjitë e përfshirjes sociale dhe në strategjitë për reduktimin e varfërisë;
- ix. Të merret në konsideratë, nëse është i nevojshëm, nënshkrimi dhe ratifikimi i Kartës Sociale Evropiane (të rishikuar), Kodit Evropian të Sigurimeve Shoqërore (ETS Nr.48), Kodi i Rishikuar Evropian i Sigurimeve Shoqërore (ETS Nr. 139) dhe Konventa Evropiane e Sigurimeve Shoqërore (ETS Nr. 78);
- x. Të zbatohen dispozitat përkatëse të rekomandimit Rec(2003)19 të Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtave sociale.

3.12. Fusha e Veprimit Nr. 12: Mbrojtja ligjore

3.12.1. Hyrje

Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejtën të njihen kudo si persona fizikë përballë ligjit. Vendet anëtare duhet të garantojnë me ligj dhënien e asistencës së nevojshme për personat me aftësi të kufizuara kurdoherë që ata kanë nevojë për ndihmë në ushtrimin e kësaj të drejte.

Personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një popullatë mjaft heterogjene, por të gjithë ata kanë të përbashkët, edhe pse në shkallë të ndryshme, nevojën për garanci shtesë për ushtrimin e plotë të të drejtave të tyre, dhe për pjesëmarrjen e tyre në shoqëri në mënyrë të barabartë me të gjithë qytetarët e tjerë.

Nevoja për të treguar kujdes të veçantë përkundrejt situatës së personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht në kuadër të ushtrimit të të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë me qytetarët e tjerë, konfirmohet nga nismat e ndërmarra në këtë fushë, si në nivelin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Parimi i mos-diskriminimit duhet të përbëjë pikënisjen e të gjitha politikave qeveritare të hartuara për garantimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara.

Ushtrimi i të drejtave ligjore përbën një të drejtë thelbësore në një shoqëri demokratike. Shpesh personave me aftësi të kufizuara u duhet të përballen me një sërë pengesash për ushtrimin e këtyre të drejtave, përfshirë këtu edhe barrierat e natyrës fizike. Kapërcimi i tyre kërkon marrjen e një sërë masash dhe veprimesh pozitive, përfshirë këtu ndërgjegjësimin e përgjithshëm të profesionistëve të fushës së ligjit lidhur me çështjet e aftësisë së kufizuar.

3.12.2. Objektivat

- i. Të garantohet ushtrimi efektiv i të drejtave ligjore të personave me aftësi të kufizuara në të njëjtin nivel me qytetarët e tjerë;
- ii. Të mbrohet dhe promovohet gëzimi i të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga personat me aftësi të kufizuara në të njëjtin nivel me qytetarët e tjerë.

3.12.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

- i. Të mundësohet mbrojtja ndaj diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet marrjes së masave legjislative, krijimit të organizmave institucionale, hartimit të procedurave të raportimit dhe krijimit të mekanizmave të apelit;
- ii. Të garantohet eliminimi i dispozitave diskriminuese përkundrejt personave me aftësi të kufizuara nga legjislacioni kombëtar;
- iii. Të mundësohet trajnimi mbi aftësinë e kufizuar dhe të drejtat e njeriut, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar për të gjithë personelin që mbulon çështjet e zbatimit të ligjit, zyrtarët publikë, personelin e sistemit të drejtësisë dhe personelin mjekësor;
- iv. Të nxitet krijimi i rrjeteve joqeveritare të lobimit të cilët punojnë në mbrojtje të të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara;
- v. Të garantohet qasja e personave me aftësi të kufizuara në sistemin e drejtësisë nëpërmjet garantimit të së drejtës së informacionit dhe komunikimit me personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet mjeteve dhe mediave të përshtatshme për ta;
- vi. Të jepet asistencë e nevojshme për ata persona që hasin vështirësi në ushtrimin e të drejtave të tyre të ligjshme, dhe të garantohet barazvlefshmëria e nivelit të asistencës së dhënë me nivelin e nevojës për asistencë;
- vii. Të merren masat e nevojshme për garantimin e lirisë së personave me aftësi të kufizuara, liri e cila mund të kufizohet vetëm në përputhje me ligjin;
- viii. Të merren masa efektive për garantimin e të drejtës së pronës dhe trashëgimisë së pronës nga ana e personave me aftësi të kufizuara, duke mundësuar mbrojtjen ligjore për menaxhimin e pronës nga ana e tyre mbi baza të barabarta;
- ix. Të garantohet se asnjë person me aftësi të kufizuara nuk do t'i nënshtrohet eksperimenteve mjekësore kundër vullnetit të tij;
- x. Të zbatohen dispozitat përkatëse të rekomandimit Nr. R (99) 4 të Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi parimet e mbrojtjes ligjore për personat me aftësi të kufizuara.

3.13. Fusha e Veprimit Nr. 13: Mbrojtja kundër dhunës dhe abuzimit

3.13.1. Hyrje

Asnjë shoqëri nuk i quan të pranueshëm aktet e dhunës apo abuzimet përkundrejt cilitdo personi; për këtë arsye çdo shoqëri mban përgjegjësi për mbrojtjen e të gjithë individëve, veçanërisht atyre që mund të preken më shumë nga këto fenomene.

Ka të dhëna, sipas të cilave shkalla e dhunës dhe abuzimit të ushtruar kundër personave me aftësi të kufizuara është mjaft më e lartë sesa shkalla e dhunës dhe abuzimit të ushtruar kundër popullatës në përgjithësi. Kjo shkallë dhune dhe abuzimi është edhe më e lartë në rastin e grave me aftësi të kufizuara, veçanërisht grave me aftësi shumë të kufizuara. Në këto raste vërehet se përqindja e dhunës së ushtruar kapërcen ndjeshëm përqindjen e dhunës së ushtruar ndaj grave pa aftësi të kufizuara. Dhuna mund të ushtrohet në institucione, qendrat e përkujdesjes apo edhe në mjedisin familjar. Dhuna mund të ushtrohet nga persona të panjohur, të huaj apo të njohur nga individi dhe mund të marrë formën e dhunës gojore, veprimeve të dhunshme apo refuzimit për plotësimin e nevojave bazike.

Edhe pse qeveritë nuk mund të garantojnë eliminimin total të akteve të dhunës, ato duhet të ndërmarrin përpjekjet maksimale për të ofruar shkallën më të lartë të mundshme të mbrojtjes. Parandalimi i dhunës mund të arrihet në shumë mënyra, veçanërisht nëpërmjet masave edukative dhe ndërgjegjësuese që mundësojnë njohjen e të drejtës së individit për mbrojtje, çka ul ndjeshëm riskun e abuzimit. Vendet anëtare duhet t'u garantojnë mbështetje adekuate personave me aftësi të kufizuara që bëhen viktimat të dhunës apo abuzimit. Ato duhet të krijojnë një sistem i cili gëzon besim të mjaftueshëm, që mundëson si raportimin e këtyre akteve ashtu edhe ndjekjen e tyre në vazhdimësi, nëpërmjet marrjes së masave që përfshijnë mbështetjen individuale. Krijimi i këtij sistemi ka si parakusht ekzistencën e një personeli të kualifikuar për identifikimin dhe reagimin ndaj akteve të dhunës dhe abuzimit.

Edhe pse gjatë viteve të fundit ka pasur punë kërkimore në këtë fushë, vërehet se është e nevojshme mbledhja e të dhënave shtesë, të cilat do të mundësojnë marrjen e vendimeve të mirëinformuara lidhur me hartimin e strategjive të ardhshme dhe shkëmbimit të praktikave më të mira.

3.13.2. Objektivat

- i. Të punohet në kuadrin e të drejtave të njeriut dhe anti-diskriminimit drejt mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuara nga të gjitha format e dhunës dhe abuzimit;
- ii. Personave me aftësi të kufizuara t'u garantohet mundësia e përfitimit nga shërbimet dhe sistemet e mbrojtjes për viktimat e dhunës dhe abuzimit.

3.13.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

- i. Të merren masa mbrojtëse për personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet zbatimit efektiv të politikave dhe nëse është e nevojshme, edhe legjislacionit kundër dhunës dhe abuzimit;
- ii. Të promovohet mundësia e ndjekjes së kurseve të trajnimit për personat me aftësi të kufizuara, në funksion të reduktimit të riskut të dhunës dhe abuzimit, çka mund të arrihet nëpërmjet dhënies së kurseve për vetëbesimin dhe fuqizimin;

- iii. Të iniciohen proçese, të merren masa dhe të hartohen protokolle të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim identifikimin e hershëm të dhunës dhe abuzimit, për të garantuar marrjen e masave kundër dhunësve, përfshirë këtu të drejtën e ankimit dhe këshillimit profesional në rast të problemeve emocionale;
- iv. Viktimave të dhunës dhe abuzimit nga rradhët e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu viktimat e dhunës në familje duhet t'u jepet mundësia e shfrytëzimit të shërbimeve mbështetëse dhe e drejta e kërimit të masave korrektive;
- v. Të parandalohet dhe të luftohet dhuna, keqtrajtimi dhe abuzimi në të gjitha situatat, nëpërmjet dhënies së mbështetjes për familjet, ndërgjegjësimin dhe edukimin qytetar, promovimit të diskutimit dhe bashkëpunimit midis palëve të interesuara;
- vi. Të mbështeten personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë dhe familjet e tyre që bien viktimë e situatave të dhunës dhe abuzimit nëpërmjet dhënies së informacionit dhe shërbimeve përkatëse;
- vii. Të ngrihen struktura kompetente për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga abuzimi në institucionet psikiatrike, qendrat dhe institucionet e kujdesit social, shtëpitë e fëmijës dhe në institucione të tjera;
- viii. Të jepet trajnimi i nevojshëm për të gjithë personelin që punon në institucionet që kanë lidhje me trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe të integrohet perspektiva e aftësisë së kufizuar në dhënien e të gjitha shërbimeve;
- ix. Të trajnohet policia dhe autoritetet juridike, në mënyrë që ato të marrin dëshmi nga personat me aftësi të kufizuara, dhe të trajtojnë me seriozitet rastet e ushtrimit të dhunës dhe abuzimit ndaj tyre;
- x. Të jepet informacion për personat me aftësi të kufizuara lidhur me mënyrat e shmangjes së dhunës dhe abuzimit, identifikimit të rasteve të saj, si dhe lidhur me mënyrat e raportimit;
- xi. Të merren masa efektive legjislative, administrative, juridike, etj, të cilat të parashikojnë sanksione të rrepta në mënyrë transparente dhe të mundësojnë vlerësimin e pavarur të shoqërisë civile në mënyrë që të parandalohen të gjitha format e dhunës fizike apo mendore, dëmtimit apo abuzimit, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, keqtrajtimit, shfrytëzimit apo rrëmbimit të personave me aftësi të kufizuara.
- xii. Të zbatohen dispozitat përkatëse të rekomandimit Rec (2002)5 të Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi mbrojtjen e gruas nga dhuna;
- xiii. Të zbatohen dispozitat përkatëse të rekomandimit Nr. R (99) 4 të Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi parimet e mbrojtjes ligjore të të rriturve me aftësi të kufizuara;
- xiv. Të zbatohet rezoluta ResAP (2005)1 mbi mbrojtjen e të rriturve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara kundër abuzimeve dhe të merret parasysh raporti shtesë përkatës.²

² Mbrojtja e të rriturve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara ndaj abuzimit, Botim I Këshillit të Evropës, Strasburg, 2003, ISBN 92-871-4919-4.

3.14. Fusha e Veprimit Nr. 14: Puna kërkimore dhe zhvillimore

3.14.1. Hyrje

Puna kërkimore, mbledhja e të dhënave statistikore dhe analizimi i tyre mundësojnë hartimin e politikave të bazuara mbi prova. Informacioni i besueshëm identifikon çështjet e reja, ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve dhe në arritjen e rezultateve efektive. Puna kërkimore gjithashtu evidenton praktikatat më të mira të punës dhe monitoron ndryshimin në shoqëri.

Mungesa e të dhënave lidhur me personat me aftësi të kufizuara përbën një pengesë për hartimin e politikave, si në nivelin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Neve kemi nevojë të nxisim dhe zhvillojmë një punë kërkimore sa më të zgjeruar, sa më të diversifikuar dhe sa më të specializuar lidhur me të gjitha fushat e aftësisë së kufizuar, dhe ta koordinojmë atë në të gjitha nivelet për të promovuar zbatimin efektiv të objektivave të përcaktuar në këtë plan veprimi.

3.14.2. Objektivat

- i. Të promovohet hartimi i politikave dhe krijimi i standardeve të bazuar mbi provat shkencore, duke përmirësuar shndërrimin e rezultateve të punës kërkimore në vendimmarrje politike;
- ii. Të harmonizohet metodologjia e mbledhjes statistikore të të dhënave, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në mënyrë që të mblidhet informacion i vlefshëm dhe i krahasueshëm;
- iii. Të përdoret dhe mbështetet i gjithë potenciali i punës kërkimore dhe zhvillimore në mënyrë multidisiplinore, në mënyrë që të promovohet pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara si dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës së tyre.

3.14.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

- i. Të hartohen strategji për mbledhjen e statistikave dhe informacionit lidhur me politikatat e aftësisë së kufizuar dhe zhvillimin e standardeve të bazuara në modelin social të aftësisë së kufizuar dhe në modelin e të drejtave të njeriut. Të rishikohet efektiviteti i strategjive ekzistuese kombëtare, dhe bazave të të dhënave të përdorura prej tyre;
- ii. Të mblidhet informacion nëpërmjet vlerësimit të nevojave, dhe të garantohet konfidencialiteti i informacionit të mbledhur mbi baza individuale. Të garantohet përdorimi i efektshëm i këtij informacioni në kuadër të vendimmarrjes së përgjithshme mbi planifikimin e shërbimeve dhe dhënien e këtyre shërbimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal;
- iii. Puna kërkimore të mundësojë mbledhjen dhe raportimin e të dhënave lidhur me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. Këto të dhëna duhet të mbulojnë të gjitha fushat e këtij Plani Veprimi;
- iv. Puna kërkimore duhet të përfshijë dimensionin gjinor, i cili lehtëson analizën e situatës së grave me aftësi të kufizuara;

- v. Të bashkërendohet përqsja ndaj punës kërkimore duke përdorur klasifikime të përbashkëta, të cilët mundësojnë analizën dhe vlerësimin krahasimor nëpërmjet bazave kombëtare atyre ndërkombëtare të të dhënave;
- vi. Të promovohen studimet dhe puna kërkimore lidhur me masat e suksesshme të rehabilitimit në funksion të shërimit dhe rehabilitimit mbi baza komunitare;
- vii. Të nxiten studimet mbi efektet e ndryshimeve demografike dhe të procesit të moshimit të popullatës mbi cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara;
- viii. Të përfshihen përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuara si dhe palë të tjera të interesuara në hartimin e strategjisë së punës kërkimore dhe mbledhjes së të dhënave;
- ix. Të mbështetet puna e aplikuar kërkimore shkencore për krijimin e teknologjive të reja të informacionit dhe të komunikimit, teknologjive ndihmëse, produkteve dhe mjeteve që mund të kontribuojnë në jetesën e pavarur dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri;
- x. Të inkurajohet studimi i produkteve, në mënyrë që të promovohet përdorimi i parimeve të projektimit universal;
- xi. Të promovohet shkëmbimi i praktikave të mira, shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi i ngushtë midis organizmave të ndryshëm për të mundësuar të dhëna të mjaftueshme për vendimmarrjen mbi politikat;
- xii. Të zbatohen projekte domethënëse studimi, pune kërkimore si dhe projekte pilot për të mbështetur zhvillimin e politikave në të gjitha fushat e këtij plani veprimi;

3.15. Fusha e Veprimit Nr. 15: Ndërgjegjësimi

3.15.1. Hyrje

Personave me aftësi të kufizuara u duhet të përballen dhe të kapërcejnë shumë pengesa për arritjen e pjesëmarrjes dhe njohjes së tyre si anëtarë me të drejta të plota në shoqëri. Pjesa më e madhe e personave me aftësi të kufizuara është e mendimit se pengesa më e madhe për integrimin e tyre të plotë është pikërisht mentaliteti i shoqërisë për ta. Personave me aftësi të kufizuara ende u duhet të ndeshen me mendësi të papranueshme të bazuara mbi paragjykimin, frikën, mosbesimit dhe pritshmërive të ulta ndaj tyre. Këto mentalitete mund të ndryshojnë nëpërmjet strategjive të efektshme të ndërgjegjësimit, të cilat duhet të përfshijnë një sërë palësh të interesuara.

Kohët e fundit shumë shtete anëtare kanë hartuar legjislacionin kundër diskriminimit dhe kanë inkurajuar nismat në favor të politikave sociale. Këto iniciativa kontribuojnë në integrimin e personave me aftësi të kufizuara në komunitetet e tyre lokale por gjithësesi ato ende nuk mjaftojnë.

Për këtë arsye, vendet anëtare duhet të përqipen të bashkëpunojnë, si me mediat ashtu edhe me aktorë të tjerë që ushtrojnë ndikim në ndryshimin e mentalitetit të njerëzve.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë të pranishëm në reklama, radio, televizion dhe në median e shkruar. Vetëm kështu është e mundur zhvendosja e paradigmës në të perceptuarit e aftësisë së kufizuar dhe të personave me aftësi të kufizuara; vetëm atëherë bëhet i mundur një ndryshim real i mendësisë së të gjithë anëtarëve të shoqërisë.

Shoqëria duhet të vihet në dijeni të faktit se personave me aftësi të kufizuara u takojnë të njëjtat të drejta njerëzore si të gjithë njerëzit e tjerë dhe se ekzistojnë shumë barrierë sociale, të cilat i pengojnë ata t'i gëzojnë dhe t'i ushtrojnë këto të drejta. Eliminimi i këtyre barrierave u sjell avantazhe jo vetëm personave me aftësi të kufizuara, por mbarë shoqërisë. Në këtë kontekst merr rëndësi njohja e kontributit të të gjithë personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, cilado qoftë shkalla e kufizimit në aftësitë e tyre.

3.15.2. Objektivat

- i. Të përmirësohet qëndrimi përkundrejt personave me aftësi të kufizuara dhe të promovohet roli i tyre si anëtarë aktivë dhe me të drejta të plota në shoqëri nëpërmjet një spektri të gjerë veprimesh;
- ii. Të ngrihet niveli i ndërgjegjësimit mbi aftësinë e kufizuar dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në kuadrin e shanseve të barabarta dhe mbrojtjes kundër diskriminimit;
- iii. Të luftohet çfarëdo mendësie negative kundrejt personave me aftësi të kufizuara, e cila mund të dëmtojë imazhin dhe interesat e personave me aftësi të kufizuara.

3.15.3. Veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga vendet anëtare

- i. Të integrohet aftësia e kufizuar në të gjitha reklamat dhe publicitetin qeveritar, në mënyrë që të arrihet ndryshimi i qëndrimeve në shoqëri;
- ii. Të nxitet media në përgjithësi dhe organizatat mediatike në veçanti që të rrisin dhe përmirësojnë portretizimin e personave me aftësi të kufizuara si qytetarë me të drejta të plota në programet e tyre si dhe në komunikimet e tyre me shkrim, përsëmbull duke përdorur kode etike mbi dinjitetin e personave me aftësi të kufizuara;
- iii. Të nxiten kanalet televizive dhe ato radiofonike të diskutojnë çështjet që kanë të bëjnë me personave me aftësi të kufizuara në programet e përditshme dhe nëse del e nevojshme, në programet e specializuara;
- iv. Të ndërmerren fushata të rregullta kombëtare të ndërgjegjësimit mbi të drejtat, potencialet dhe kontributet e personave me aftësi të kufizuara;
- v. Të përdoren mjete inovative dhe praktike për t'u bërë të qartë fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve pengesat e hasura nga personat me aftësi të kufizuara;
- vi. Të nxiten personat me aftësi të kufizuara, si dhe organizatat e tyre që të promovojnë vetveten në mediat lokale dhe kombëtare, duke menaxhuar dhe dhënë orientime rreth marrëdhënieve të tyre me mediat;

vii. Të mbështeten dhe të promovohen shembujt e praktikës së mirë në të gjitha fushat e jetës dhe të rritet ndërgjegjësimi në sferën e arsimit, sferat e punësimit në komunitet.

4. Aspekte multidisiplinore

4.1 Hyrje

Popullata evropiane me aftësi të kufizuara përballet me barriera nga më të ndryshmet. Brenda kësaj popullate hasen grupe të caktuar, të cilëve u duhet të përballen me barriera specifike apo me diskriminim të dyfishtë.

Këta persona apo grupe personash i ekspozohen një risku më të lartë përjashtimi shoqëror, i cili ndikon negativisht në nivelet e tyre të pjesëmarrjes në shoqëri. Për këtë arsye, politikbërësit duhet të marrin parasysh nevojat e veçanta të grupeve specifike të personave me aftësi të kufizuara në procesin e hartimit të strategjive dhe politikave të tyre mbi pjesëmarrjen qytetare. Deklarata e Malagës vë në dukje dy grupe të tilla, të cilat duhet të trajtohen me vëmendje të veçantë përgjatë zbatimit të këtij plani veprimi – gratë me aftësi të kufizuara dhe personat në nevojë për nivel të lartë mbështetjeje. Raportet e grupit të punës mbi diskriminimin ndaj grave me aftësi të kufizuara, si dhe ndaj personave në nevojë për nivel të lartë mbështetjeje kanë analizuar faktorët që kanë ndikim specifik ndaj këtyre grupeve, dhe kanë propozuar marrjen e masave po kaq specifike, të cilat përfshijnë njëkohësisht disa fusha veprimi, duke kombinuar jetesën e pavarur, arsimimin, punësimin etj.³

Grupe të tjera, për të cilat del i nevojshëm trajtimi multidisiplinor përfshijnë fëmijët me aftësi të kufizuara, të moshuarit me aftësi të kufizuara, personat me aftësi të kufizuara nga minoritetet (përshembull romët, migrantët, refugjatët, të zhvendosurit, apo minoritete të tjera etnike, kulturore apo gjuhësore). Hartuesit e politikave duhet të kenë parasysh barrierat dhe sfidat me të cilat përballet secili nga këto grupe, në mënyrë që të përfshijnë në politikat e tyre masat për eliminimin e këtyre barrierave, si dhe të garantojnë që këta qytetarë me aftësi të kufizuara të përmbushin potencialet e tyre ashtu si të gjithë qytetarët e tjerë.

4.2 Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara⁴ hasin pengesa të shumta përsa i përket pjesëmarrjes në shoqëri, për shkak të diskriminimit të dyfishtë, si për shkak të gjinisë, ashtu dhe për shkak të vetë aftësisë së kufizuar. Edhe pse situata e përgjithshme e personave me aftësi të kufizuara ka shënuar përmirësime të ndjeshme përgjatë viteve të fundit, mund të thuhet se jo të gjithë personat me aftësi të kufizuara kanë përfituar në mënyrë të barabartë nga to. Ndodh që gratë me aftësi të kufizuara nuk përfitojnë në mënyrë të barabartë me burrat me aftësi të kufizuara nga përparimet e shënuara në fushën e aftësisë së kufizuar.

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave efektive, si dhe marrja e masave me ndikim të qëndrueshëm në fushën e aftësisë së kufizuar duhet të marrë parasysh garantimin e shanseve të barabarta midis burrave dhe grave me aftësi të kufizuara. Situata specifike e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara duhet të përbëjë një pikënisje për hartimin e politikave të integritimit gjinor, si dhe politikave të integritimit të aftësisë së kufizuar në të gjitha nivelet, pra në nivelin ndërkombëtar, kombëtar, rajonal dhe lokal.

³ Diskriminimi kundër grave me aftësi të kufizuara, Botim i Këshillit të Evropës, Strasburg, 2003, ISBN 92-871-5316-7, Jetesa në komunitet për personat me aftësi të kufizuara me nevoja për përkujdesje të veçantë, Këshilli i Evropës, Strasburg, 2004.

⁴ Të gjitha referencat ndaj grave me aftësi të kufizuara në këtë plan veprimi nënkuptojnë edhe vajzat me aftësi të kufizuara.

Në këtë aspekt del e nevojshme heqja e barrierave të cilat pengojnë gratë me aftësi të kufizuara të gëzojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre në të njëjtën mënyrë si të gjitha gratë dhe burrat e tjerë. Për këtë qëllim duhen marrë masa të cilat shtrihen mbi një sërë fushash, përfshirë marrëdhëniet familjare, prindërore, jetën familjare, seksualitetin, si dhe mbrojtjen nga dhuna dhe abuzimi. Këto masa duhet të synojnë garantimin e shanseve të barabarta të pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike, arsim, trajnim, punësim, si dhe në jetën sociale dhe kulturore. Shumë prej këtyre fushave të politikbërjes janë trajtuar në fushat specifike të veprimit në këtë plan veprimi, por ato duhet të shihen më në detaj për të kuptuar mënyrën se si duhen trajtuar faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nga ana e vendeve anëtare.

4.3. *Persona me aftësi të kufizuara me nevoja të veçanta për mbështetje*⁵

Njëri ndër grupet më në nevojë ndër personat me aftësi të kufizuara përbëhet nga individët me aftësi të kufizuara, të cilët, për shkak të kompleksitetit dhe natyrës së dëmtimeve të pësuar, kanë nevoja të veçanta për mbështetje. Cilësia e jetës së këtyre personave varet në masë të madhe nga ekzistenca dhe cilësia e shërbimeve që plotësojnë nevojat e nevojat e tyre dhe të familjeve të tyre për pjesëmarrje në shoqëri. Këto shërbime duhet të synojnë arritjen e një pjesëmarrjeje reale shoqërore, dhe të mos jenë thjesht një kopje e shërbimeve që u jepen në përgjithësi personave me aftësi të kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara me nevoja të veçanta për mbështetje kanë shumë gjasa të jetojnë në institucione të kujdesit shëndetësor, apo në disa raste, në familjet e tyre, çka i ekspozon ata ndaj rrezikut të izolimit social për shkak të mungesës së kontaktit me shoqërinë dhe komunitetin. Për këtë arsye, ky grup ka nevojë për shërbime intensive dhe të qëndrueshme, të krijuara në mënyrë specifike për të përmbushur nevojat e tyre.

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ndaj këtij grupi personash është një domosdoshmëri, në mënyrë që të garantohet plotësimi i nevojave të tyre pa qenë nevoja të dilet nga suazat e modelit të shërbimeve komunitare. Vendet anëtare duhet të marrin në konsideratë faktin se arritja e këtij synimi kërkon planifikim dhe bashkërendim ndër-institucional në nivelin kombëtar dhe lokal.

4.4. *Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara*

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës bazohet mbi katë parime themelore – të drejtën e fëmijës për të mos u diskriminuar; marrjen parasysh të interesit të fëmijës në marrjen e të gjitha vendimeve; të drejtën e fëmijës për të jetuar dhe për t'u zhvilluar; dhe të drejtën e fëmijës për të shprehur mendimin e tij. Djemtë dhe vajzat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të gëzojnë të njëjtat të drejta. Vendet anëtare duhet të njihen më na afër me nevojat e këtij grupi në mënyrë që të informojnë vendimmarrjen, planifikimin, dhe praktikën e punës e tyre përgjatë një spektri të gjerë politikash.

Nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të familjeve të tyre duhet të vlerësohen në mënyrë të kujdesshme nga autoritetet kompetente në mënyrë që të mund të merren masa mbështetëse të cilat t'u mundësojnë fëmijëve me aftësi të kufizuara të rriten në gjirin e familjeve të tyre, si dhe të përfshihen në jetën dhe aktivitetin e fëmijëve të komuniteteve të tyre. Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë nevojë të

⁵ Jetesa në komunitet për personat me aftësi të kufizuara me nevoja për përkujdesje të veçantë, cituar më lart

marrin arsimim për të pasuruar jetën e tyre dhe për të përmbushur potencialet e tyre në shkallën më të lartë të mundshme.

Dhënia e shërbimeve cilësore dhe krijimi i strukturave për mbështetjen e familjeve mundëson një fëmijëri të pasur me ngjarje dhe përjetime, si dhe hedh bazat për një jetë të mëvonshme të pavarur dhe pjesëmarrëse. Për këtë arsye është e rëndësishme që politikbërësit të marrin në konsideratë nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe familjeve të tyre përgjatë hartimit të politikave të aftësisë së kufizuar, si dhe përgjatë integritit të këtyre politikave në politikat e përgjithshme për fëmijët dhe familjet.

Pjesëmarrja dhe jeta aktive shoqërore mbështetet mbi të gjitha mbi të ushtrimin e të drejtave, përdorimin e mjeteve, hapësirave, mundësive, dhe, aty ku është e mundur, marrjen e mbështetjes për të marrë pjesë dhe ndikuar në vendimmarrje, si dhe për t'u përfshirë në aktivitete dhe veprime, për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të mirë. Organizatat rinore të personave me aftësi të kufizuara duhet të përfshihen në hartimin e politikave dhe programeve për rininë. Zërat e të rinjve me aftësi të kufizuara duhet të dëgjohen më shumë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ta.

Të rinjtë me aftësi të kufizuara ende përballen me pengesa të konsiderueshme përse i përket pjesëmarrjes së tyre në të gjitha fushat e jetës, si arsimim, punësim, sport, kulturë, argëtim, dhe jetesë në komunitet. Këto çështje duhet të trajtohen mbi bazën e një strategjie gjithëpërfshirëse, e cila duhet të ravigjëzojë mënyrat dhe rrugët për arritjen e pjesëmarrjes së plotë shoqërore të të rinjve me aftësi të kufizuara. Në përputhje me Kartën Evropiane mbi pjesëmarrjen e të rinjve në jetën shoqërore në nivel lokal dhe rajonal, pjesëmarrja aktive të të rinjve në vendimmarrjen në nivel lokal dhe rajonal është thelbësore për ndërtimin e shoqërive më demokratike, më përfshirëse, dhe me një shkallë më të lartë mirëqenieje.

4.5. Moshimi i personave me aftësi të kufizuara

Moshimi i personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht atyre me nevoja për përkujdesje të veçantë për shkak të natyrës së dëmtimeve të tyre, paraqet një sfidë të madhe për shoqërinë evropiane. Kjo sfidë përfshin dhënien e mbështetjes për individët dhe familjet e tyre, veçanërisht në rastin kur prindërit e moshuar luajnë rolin e kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara. Përballja me këto sfida kërkon zbatimin e përqsasjeve inovative përgjatë një harku të gjerë politikash dhe shërbimesh. Raportet e Këshillit të Evropës identifikojnë disa çështje të rëndësishme për këtë grup personash, dhe japin disa sugjerime për punën që duhet bërë në këtë drejtim.

Bashkërendimi i masave për plotësimin e nevojave specifike me qëllim mbajtjen në komunitet të personave të moshuar me aftësi të kufizuara kërkon vlerësimin e nevojave individuale, planifikimin dhe dhënien e shërbimeve të kërkuara. Aftësia e kufizuar duhet të merret parasysh përgjatë hartimit të strategjive për moshën e tretë.

Është e qartë se çështjet dhe faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen e personave të moshuar me aftësi të kufizuara në jetën dhe aktivitetet e përditshme duhet të merren parasysh përgjatë përcaktimit të masave që do të ndërmerren në kuadër të këtij plani veprimi.⁶

⁶ Kuadri për analizën cilësore dhe sasore të të dhënave për moshimin e personave me aftësi të kufizuara, Botim i Këshillit të Evropës Strasburg, 1998, ISBN 92-871-3327-1.

4.6. Personat me aftësi të kufizuara nga minoritetet dhe migrantët

Personat me aftësi të kufizuara nga grupet e minoritetit, migrantët dhe refugjatët me aftësi të kufizuara mund të hasin një sërë pengesash për shkak të diskriminimit të drejtpërdrejtë, apo për shkak të mungesës së njohurive lidhur me shërbimet publike.

Si shembull mund të përmendim faktin se, megjithëse në Evropë po tregohet gjithnjë e më shumë kujdes ndaj popullatës rome, mbetet ende shumë për të bërë për njohjen e statusit të tyre si anëtarë me të drejta të plota në shoqëri. Ndodh që brenda vetë komuniteteve të tyre, personat me aftësi të kufizuara të konsiderohen si “të padukshëm”, për këtë arsye ata përbëjnë një grup me nevoja mjaft të veçanta për përkujdesje.

Arsimimi, punësimi, shërbimet sociale dhe shëndetësore, si dhe jeta kulturore janë fusha që duhet të trajtohen me prioritet për të gjithë këta grupe.

Vendet anëtare duhet t’i kushtojnë vëmendje dimensionit gjuhësor dhe kulturor, si dhe nevojave specifike të personave me aftësi të kufizuara nga rradhët e minoriteteve.

5. Zbatimi dhe monitorimi

5.1. Hyrje

Qeveritë e vendeve anëtare janë përgjegjëse për zbatimin e politikave në fushën e aftësisë së kufizuar në nivel kombëtar, si dhe për marrjen e masave specifike të përcaktuara në secilën fushë veprimi.

Ky plan veprimi njeh faktin se politikat kundër diskriminimit, strukturat administrative, resurset, demografia etj, ndryshojnë nga vendi në vend. Për këtë arsye, plani i veprimit u mundëson vendeve anëtare që të përcaktojnë prioritetet e tyre kombëtare dhe të zbatojnë një përjasje progresive përkundrejt zbatimit të planit të veprimit duke përdorur për këtë qëllim mjetet më të përshtatshme për ta.

Plani synon, që gjatë zbatimit të masave të tij specifike, vendet anëtare të marrin parasysh përsa vijon:

- Parimet mbështetëse të këtij plani veprimi, përfshirë këtu të drejtat e individëve për tu mbrojtur kundër diskriminimit, të drejtat për shanse të barabarta dhe respektin për të drejtat qytetare;
- Aspektet multidisiplinore, përfshirë këtu nevojat specifike të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, personave me aftësi të kufizuara me nevoja të veçanta për përkujdesje, të moshuarit me aftësi të kufizuara, migrantët me aftësi të kufizuara, si dhe personat me aftësi të kufizuara nga minoritetet, sëbashku me rolin thelbësor që luajnë shërbimet cilësore dhe trajnimi në mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara;
- Përfshirjen e organizatave përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fazat e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të këtij plani veprimi në nivel evropian, kombëtar, rajonal dhe lokal.

5.1.1 Projektimi Universal

Përshtatshmëria ndërtimore ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse e cila garanton shanset e barabarta. Projektimi i ndërtesave, mjediseve, produkteve, mjeteve të komunikimit, si dhe i sistemeve elektronike ka rëndësi të veçantë për mundësimin e pjesëmarrjes dhe pavarësisë së personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës.

Projektimi universal është një mënyrë efektive për përmirësimin e përshatshmërisë ndërtimore, si dhe për përmirësimin e shërbimeve dhe produkteve. Projektimi universal garanton përshtatshmërinë e mjedisit ndërtimor, produkteve, dhe ndërtesave që fazën e konceptimit të tyre, pa qenë e nevojshme që këto mjedise, produkte apo ndërtesa, t'u nënshtrohen ndërhyrjeve përshtatëse në një fazë të mëvonshme. Duhet patur parasysh se jo gjithnjë është e mundur të realizohet përshtatja e plotë e ndërtesave të vjetra apo historike, dhe se ekzistojnë shumë barriera që pengojnë personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në të gjitha aspektet e shoqërisë. Promovimi i parimit të Projektimit Universal, zbatimi i gjerë i tij, dhe pjesëmarrja e përdoruesve në të gjitha fazat e projektimit, ka rëndësi të dorës së parë për përmirësimin e përshtatshmërisë së mjedisit të ndërtuar, sistemeve të transportit dhe komunikimit, si dhe përshtatshmërisë së produkteve.

5.1.2. Cilësia e shërbimeve dhe trajnimi i personelit

Standardet e cilësisë dhe trajnimi janë parime që qëndrojnë në themel të të gjitha masave të parashikuara në këtë plan veprimi. Tashmë shumë vende evropiane kanë filluar punën sistematike për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe për trajnimin e personelit. Të gjitha politikat, shërbimet dhe veprimet duhet të bazohen në standarde të larta të cilësisë, dhe të zbatohen nga personel i trajnuar dhe kompetent. Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë pikënisja e të gjitha shërbimeve që jepen. Motivimi kryesor për politikat e qëndrueshme në këtë fushë duhet të jetë plotësimi i nevojave të klientit. Për këtë arsye, ka shumë rëndësi që personave me aftësi të kufizuara, si përdorues të shërbimeve, duhet t'u mundësohet pjesëmarrja aktive në garantimin e cilësisë dhe monitorimin e shërbimeve.

Trajnimi është një element thelbësor për garantimin e cilësisë së shërbimit. Trajnimi nuk duhet të përfshijë thjesht dhe vetëm personelin që jep shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, por edhe vetë personat që hartojnë politikat që ndikojnë në jetesën e personave me aftësi të kufizuara. Trajnimi duhet të përfshijë edhe aspektin e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në kuadrin e të drejtave të njeriut.

5.1.3. Përqasje integruese ose përgjegjësi sektoriale

Si përqasje integruese, ashtu edhe përgjegjësia sektoriale në hartimin e politikave dhe dhënien e shërbimeve, luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse. Përqasja integruese dhe përgjegjësia sektoriale janë dy shtyllat mbështetëse të këtij plani veprimi. Përqasja integruese ka të bëjë me integrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet që u ofrohen qytetarëve të tjerë. Qëllimi i kësaj përqasjeje është kalimi nga politikave që rezultojnë në përjashtim, në politika që garantojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuara në shkallën më të lartë të mundshme. Megjithatë, përqasja integruese nuk përjashton ekzistencën e politikave specifike për aftësinë e kufizuar, në rast se këto politika specifike janë zgjidhja më e mirë për personat me aftësi të kufizuara (e ashtuquajtura përqasje e dyfishtë).

Kjo përqasje të jep të kuptosh se politikat e aftësisë së kufizuara nuk konsiderohen më si përgjegjësia e një ministrie të vetme, apo e një institucioni të veçantë. Të gjitha ministrinë mbajnë përgjegjësinë e integritit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në punën e tyre. Bashkërendimi midis sektorëve të ndryshëm qeveritarë dhe krijimi i pikave fokale për çështjet e aftësisë së kufizuar ka rëndësi të madhe për suksesin e përqasjes integruese.

5.2. Zbatimi

Qeveritë e vendeve anëtare mbajnë përgjegjësinë kryesore për zbatimin e politikave të aftësisë së kufizuar në nivelin kombëtar, dhe në veçanti, ato janë përgjegjëse për zbatimin e veprimeve specifike të përcaktuara në secilën fushë veprimi. Vendet anëtare duhet të fillojnë vlerësimin e programeve dhe politikave të tyre për aftësinë e kufizuar si dhe parimeve mbështetëse të tyre përkundrejt udhëzimeve të Planit të Veprimit të Këshillit të Evropës për Aftësinë e Kufizuar, në mënyrë që të identifikohen fushat ku ka ende nevojë për përmirësime, dhe të përcaktohen masat specifike që duhet të merren në këtë drejtim.

Mbi bazën e këtij vlerësimi, vendet anëtare duhet të hartojnë strategji dhe të bashkërendojnë programet dhe politikat e tyre në fushën e aftësisë së kufizuar në kuadrin e përgjithshëm që jepet nga Plani i Veprimit të Këshillit të Evropës për Aftësinë e Kufizuar, si dhe nga resurset financiare kombëtare.

Përcaktimi i prioriteteve dhe përgatitja e një tabele afatesh për të matur dhe vlerësuar progresin janë përgjegjësi e secilit vend anëtar.

Zbatimi i këtij plani veprimi nga vendet anëtare duhet të mbështetet nga një përjasje e koordinuar, e cila duhet të përfshijë të gjitha palët e interesuara, përfshirë këtu organizatat joqeveritare të personave me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të zbatimit të këtij plani veprimi, vendet anëtare duhet të marrin parasysh edhe çështjen e përcaktimit të aftësisë së kufizuar, nëse shihet e nevojshme.

Vendet anëtare do ta përkthejnë këtë plan veprimi në gjuhët e tyre zyrtare dhe do t'i vendosin këto përkthime në formate alternative të kuptueshme për personat me aftësi të kufizuara. Vendet anëtare do ta promovojnë planin e veprimit duke përfshirë të gjitha palët e interesuara në zbatimin e tij në kuadrin e sigurimit të mbështetjes afatgjatë për të.

Këshilli i Evropës do të ndihmojë vendet anëtare për zbatimin e planit të veprimit, pas marrjes së kërkesës nga ana e tyre. Vendet anëtare duhet të kenë parasysh mundësinë e bashkëpunimit me Bankën e Zhvillimit të Këshillit të Evropës (CEB), e cila mund të financojë projekte të besueshëm që synojnë zbatimin e planit të veprimit në nivel kombëtar.

5.3. Monitorimi

Qeveritë e vendeve anëtare mbajnë përgjegjësinë kryesore për monitorimin e planit të veprimit të Këshillit të Evropës në nivel kombëtar. Lidhur me këtë, qeveritë e vendeve anëtare përcaktojnë mënyrat e vlerësimit dhe monitorimit në bashkëpunim me palët e interesuara, dhe në mënyrë të veçantë me organizatat joqeveritare të personave me aftësi të kufizuara.

Në nivelin evropian, monitorimi i këtij plani veprimi duhet të përqendrohet në fuqizimin e bashkëpunimit në fushën e aftësisë së kufizuar, dhe duhet të mundësojë në mënyrë të strukturuar shkëmbimin efektiv të informacionit, praktikave të mira dhe përvojave të punës.

Monitorimi efektiv i këtij plani veprimi u kërkon vendeve anëtare që të informojnë në mënyrë të vazhdueshme Këshillin e Evropës lidhur me ecurinë e zbatimit të tij. Në këtë kontekst, marrin vlerë të veçantë raportet e qeverive kombëtare përballë parlamenteve, si dhe raportet e monitorimit që realizohen nga organizatat joqeveritare.

Ky proces do të ndiqet në vazhdimësi nga forumi përkatës për monitorimin e planit të veprimit, i cili do të menaxhojë procesin e monitorimit, ku përfshihet edhe përcaktimi i afateve të zbatimit, si dhe përcaktimi i datës së vlerësimit të arritjeve të tij në kuadrin afatmesëm.

Ky forum mund t'u sugjerojë vendeve anëtare analizimin më në detaj të disa çështjeve specifike. Ai do të garantojë informimin e vazhdueshëm të Komitetit të Ministrave lidhur me progresin e arritur në zbatimin e këtij plani veprimi.

Organizatat ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara do të marrin pjesë në këtë proces brenda rregullave të miratuara procedurale. Gjithashtu, edhe palë të tjera të interesuara mund të ftohen për të kontribuar në këtë proces, sipas mënyrave të specifikuara në termave të referencës të forumit të monitorimit.

**Deklarata Ministeriale e Malagës mbi Personat me Aftësi të Kufizuara
“Duke ecur drejt pjesëmarrjes së plotë si qytetarë”**

*(Miratuar në Konferencën e Dytë Evropiane të Ministrave
Përgjegjës për politikën e integritit për personat me
aftësi të kufizuara, Malaga, Spanjë, 7 – 8 Maj 2003)*

1. Ne, ministrat përgjegjës për politikën e integritit për personat me aftësi të kufizuara, pjesëmarrës në mbledhjen e mbajtur nga 7 në 8 Maj 2003 në Malagë me ftesë të qeverisë spanjolle në kuadër të konferencës së dytë evropiane të ministrave, të organizuar nga Këshilli i Evropës,

1. Duke qenë të vetëdijshëm se:

2. Synimi i Këshillit të Evropës, ashtu siç shkruhet në statutin e tij, është “të sjellë më shumë barazi midis vendeve anëtare, në mënyrë që të mbrohen dhe të përmbushen idealet dhe parimet, të cilat qëndrojnë në themel të trashëgimisë së tyre të përbashkët, si dhe të ndihmojë në zhvillimin e tyre social dhe ekonomik”;

3. Rezultati i konferencës së parë të ministrave përgjegjës për politikën për personat me aftësi të kufizuara, të mbajtur në Paris, më 7 dhe 8 Nëntor të vitit 1991, me titullin “Jetesë e pavarur për personat me aftësi të kufizuara”, e cila i parapriu miratimit të rekomandimit Nr. R (92) 6 nga ana e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi një politikë koherente në favor të personave me aftësi të kufizuara;

4. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe ushtrimi i plotë i tyre përbën një parakusht për pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, dhe se parimi i shanseve të barabarta për personat me aftësi të kufizuara përbën një vlerë themelore të pranuar nga të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës;

5. Kontributi i lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara në konferencën e dytë ministrore të Këshillit të Evropës mbi aftësinë e kufizuar me titullin “Nga fjalët në vepra”, të sanksionuar në forumin e OJQ-ve evropiane të 8 prillit të vitit 2003 në Madrid;

6. Ekzistenca e ndryshimeve të qenësishme midis vendeve anëtare të Këshillit të Evropës përse i përket situatave të tyre politike, ekonomike dhe sociale, si dhe fakti se disa prej këtyre vendeve, veçanërisht ato me ekonomi në tranzicion, mund të kenë më pak kushte dhe mundësi për zbatimin e politikave moderne të aftësisë së kufizuar, dhe kanë nevojë për më shumë mbështetje në këtë drejtim;

7. Politikën për personat me aftësi të kufizuara përballen me sfida politike, ekonomike, sociale, demografike, kulturore, dhe teknologjike, duke patur parasysh faktin se gjatë dekadës së fundit Evropa ka përjetuar ndryshime të shumta, të cilat kanë ndikuar në cilësinë e jetesës së popullsisë, që kanë ngritur sfida në njërën anë, por që kanë krijuar mundësi për zhvillimin e politikave koherente për personat me aftësi të kufizuara në anën tjetër;

8. Dy janë aspektet thelbësore që karakterizojnë situatën e personave me aftësi të kufizuara: në njërin anë, rritja e vazhdueshme e popullatës së moshuar në Evropë, e cila duhet të merret parasysh në hartimin e të gjitha strategjive të ardhshme të kohezionit social, të bazuara në parimin e parandalimit të varësisë ndaj shërbimeve mbështetëse gjatë rrjedhës së jetës, si dhe në parimin e ruajtjes së cilësisë së jetesës edhe përgjatë moshës së tretë; nga ana tjetër, përparimet shkencore në fushën e shëndetësisë, si dhe përmirësimi i kushteve të jetesës ka sjellë rritjen e jetëgjatësisë së personave me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, çka ka sjellë lindjen e nevojave të reja për shërbime, mbështetje ekonomike dhe mbrojtje të të drejtave të tyre njerëzore;

9. Viti 2003 u shpall nga Bashkimi Evropian si viti evropian i personave me aftësi të kufizuara, me synimin e rritjes së ndërgjegjësimit mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për shanse të barabarta, si dhe për ushtrimin e plotë të të drejtave të tyre;

10. Komiteti *ad-hoc* i Organizatës së Kombeve të Bashkuara ka sugjeruar “të merren në konsideratë propozimet për hartimin e një konvente ndërkombëtare tërësore dhe integrale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara”;

11. Puna e Komitetit të Këshillit të Evropës për Rehabilitimin dhe Integrimin e Personave me Aftësi të Kufizuara ka përmirësuar bashkëpunimin ndërqeveritar në kuadrin e Marrëveshjes Pjesore në fushën e shëndetit publik dhe çështjeve sociale;

12. Arritjet e Këshillit të Evropës, si dhe organizatave apo institucioneve të tjera ndërkombëtare, të renditura në shtojcën e kësaj deklarate;

2. Shpallim:

13. Angazhimin tonë për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë qytetarët e vendeve anëtare, në përputhje me përcaktimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilës të gjitha qeniet njerëzore janë lindur të lira dhe të barabarta në të drejta dhe dinjitet, si dhe me potencialin për të kontribuar konstruktivisht në zhvillimin dhe mirëqenien e shoqërisë, dhe se të gjithë personat janë të barabartë përballë ligjit dhe gëzojnë të drejtën për të gëzuar mbrojtje të njëjtë ligjore;

14. Se masat për ushtrimin e plotë dhe efektiv të të gjitha të drejtave të njeriut, sipas përcaktimeve të traktateve ndërkombëtare dhe evropiane, duhet të zbatohen pa diskriminim apo çfarëdolloj dallimi për çfarëdo arsyeje, përfshirë këtu aftësinë e kufizuar;

15. Se vullneti ynë, i shprehur në konferencën e parë të ministrave përgjegjës për politikën për personat me aftësi të kufizuara, të mbajtur në Paris në vitin 1991, për promovimin e një politike të integruar dhe koherente për personat me aftësi të kufizuara, si dhe rekomandimi Nr. R (92) 6 “Mbi një politikë koherente për personat me aftësi të kufizuara” kanë nxitur vendet anëtare të miratojnë masa legjislative dhe politika, të cilat kanë sjellë zhvillim në rrugën drejt pjesëmarrjes së plotë, dhe se ky rekomandim përbën një dokument thelbësor reference, i cili duhet të shërbejë si platformë për veprime të mëtejshme;

16. Se rritjes së pjesëmarrjes qytetare i personave me aftësi të kufizuara duhet t’i paraprijë fuqizimi i individit, në mënyrë që ai/ajo të kontrollojë plotësisht jetën e vet, çka mund të kërkojë marrjen e masave mbështetëse specifike;

3. Marrim parasysh:

17. Se objektivi ynë kryesor për dekadën e ardhshme është përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, duke theksuar rëndësinë e integritit dhe pjesëmarrjes së tyre të plotë në shoqëri, duke qenë se një shoqëri integruese dhe gjithëpërfshirëse është në të mirën e të gjithë shoqërisë;
18. Se masat që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara duhet të bazohen në vlerësimin e qenësishëm të situatës, potencialeve dhe nevojave të tyre, dhe në zhvillimin e përfaqësive inovative në dhënie dhe shërbimeve, duke patur parasysh preferencat, të drejtat dhe rrethanat e tyre;
19. Se strategjia për realizimin e këtij objektivi duhet të shprehen në një plan të ardhshëm veprimi për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara të të gjitha moshave, me fokus të veçantë tek gratë me aftësi të kufizuara dhe tek personat me nevoja të veçanta për mbështetje, në mënyrë që të gjithë të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore, njerëzore dhe civile;
20. Se del i nevojshëm zbatimi i një përfaqëse të integruar për hartimin e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare mbi aftësinë e kufizuar, si dhe legjislacionit përkatës, i cili duhet të reflektojë nevojat e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e politikbërjes, veçanërisht në fushat kyçe të strehimit, arsimimit, kualifikimit profesional, punësimit, përshtatshmërisë ndërtimore, transportit publik, informimit, kujdesit shëndetësor, dhe mbrojtjes sociale;
21. Se njëri ndër objektivat tanë kryesorë mbetet marrja e masave në fushën ekonomike, sociale, arsimore, mjedisore, dhe në fushën e punësimit, për të garantuar përmbushjen e kapaciteteve të plota të çdo individit me aftësi të kufizuara përgjatë jetës, si dhe për të parandaluar aftësinë e kufizuar;
22. Se arsimi është njëri ndër instrumentet kryesorë për integrimin social, dhe se duhen marrë të gjitha masat për t'u mundësuar fëmijëve me aftësi të kufizuara pjesëmarrjen në arsimin e përgjithshëm, nëse kjo konsiderohet me interes për fëmijën. Gjithashtu ka rëndësi mbështetja e kalimit të studentëve me aftësi të kufizuara nga auditorët e studimit në tregun e punës, si dhe zhvillimi i konceptit të të mësuarit gjatë të gjithë jetës;
23. Se barazia e shanseve për pjesëmarrje në tregun e punës është një element kyç për pjesëmarrjen sociale; për këtë arsye, duhet punuar për integrimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës, mundësisht në tregun e lirë, duke zhvendosur fokusin tonë drejt vlerësimit të aftësive dhe zbatimit të politikave aktive, duke patur parasysh se diversifikimi i krahut të punës nëpërmjet integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës përbën një vlerë të shtuar për shoqërinë;
24. Se të kuptuarit e natyrës sociale të teknologjisë, si dhe përdorimi maksimal i potencialeve të teknologjive të reja për rritjen e komunikimit të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat ka rëndësi të dorës së parë;
25. Se arritjet shkencore në fushën e shëndetësisë, si dhe përmirësimi i kushteve të jetesës ka rritur jetëgjatësinë e personave me aftësi të kufizuara fizike, psikologjike, dhe intelektuale, çka shton nevojat dhe sfidat përkundrejt shërbimeve të përkujdesjes, sfida të cilat duhet të adresohen me përfaqëse inovative;

26. Se nevoja për garantimin dhe shtimin e jetëgjatësisë nuk duhet të shkaktojë rritjen e varësisë së një numri gjithnjë e më të madh personash nga shërbimet mbështetëse; kjo prirje duhet të ndalet duke mbështetur një jetë të shëndetshme që në fazat më të hershme të jetës, e cila mundëson një shëndet më të mirë fizik dhe mendor të fazat e mëvonshme të saj;

27. Se është e nevojshme marrja e masave për heqjen e barrierave, si dhe zbatimi i parimit të projektimit universal, në mënyrë që të shmanget krijimi i barrierave në të ardhmen;

28. Se ekziston një numër i vogël, por në rritje i personave me aftësi të kufizuara, të cilët kanë nevojë për përkujdesje të veçanta, ndaj njihet nevoja për fuqizimin e strukturave mbështetëse për këta individë dhe familjet e tyre, pa dalë nga modeli i shërbimeve të bazuara në komunitet;

29. Se situata e grave me aftësi të kufizuara në Evropë kërkon rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit dhe marrjen e masave specifike për të garantuar pavarësinë, autonominë, pjesëmarrjen dhe integrimin social të tyre; për këtë arsye, duhen marrë masa në favor të një përqasjeje që merr parasysh integrimin gjinor në zhvillimin e politikave të aftësisë së kufizuar.

4. Marrim përsipër:

30. Të punojmë në kuadrin e anti-diskriminimit dhe në kuadrin e të drejtave të njeriut për integrimin e shanseve të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e politikbërjes;

31. Të mos diskriminojmë mbi bazën e origjinës së aftësisë së kufizuar, apo mbi bazën e identitetit të personit me aftësi të kufizuara;

32. Të rritim mundësitë e personave me aftësi të kufizuara për një jetë të pavarur në komunitet, nëpërmjet zbatimit në vazhdimësi të parimeve të teknologjisë gjithëpërfshirëse dhe projektimit universal, *inter alia*, në ndërtimin e mjediseve urbane, ndërtesave publike, sistemeve të komunikimit dhe në fushën e strehimit;

33. Të punojmë për fuqizimin e koordinimit shumë-nivelësh midis departamenteve të qeverisë, me një angazhim të veçantë për promovimin e shanseve të barabarta në shërbimet e përgjithshme për qytetarët, në shërbimet shëndetësore, në sistemin e drejtësisë, si dhe për përmirësimin e llogaridhënies midis autoriteteve lokale, rajonale dhe kombëtare;

34. Të promovojmë dhënien e shërbimeve cilësore, të cilat përmbushin nevojat e individëve me aftësi të kufizuara, shërbime të cilat përdoren nëpërmjet kriterëve të publikuara të përzgjedhjes, bazuar mbi një vlerësim të plotë dhe të drejtë, të përcaktuar nga zgjedhja e vetë personit me aftësi të kufizuara, nga autonomia, mirëqenia, përfaqësimi i tij, e cila të mbështetet nga garancitë e nevojshme, të kompletuara nga dispozitat, rregulloret dhe mundësia e ankimimit në një institucion të pavarur; gjithashtu të konsolidohen dhe fuqizohen masat tashmë të marra në këtë drejtim;

35. Të promovojmë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e jetës nëpërmjet arsimit dhe nëpërmjet angazhimit përkundrejt personave me aftësi të kufizuara se ata do të trajtohen si qytetarë me të drejta të plota mbi jetën e tyre;

36. Të rritim integrimi i personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës nëpërmjet zhvendosjes së fokusit të punës drejt vlerësimit të aftësive, veçanërisht aftësive profesionale të personave me aftësi të kufizuara, si dhe duke mundësuar si kualifikimin profesional, ashtu edhe punësimin e tyre;
37. Të marrim parasysh nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të familjeve të tyre, si dhe të të moshuarve me aftësi të kufizuara, pa u shmangur nga angazhimet aktuale përkundrejt të rriturve me aftësi të kufizuara në moshë pune, pavarësisht nëse ata janë apo nuk janë të punësuar, duke vërejtur se punësimi nuk duhet të shihet si mënyra e vetme për ushtrimin e të drejtave të qytetarisë, si fusha e vetme e pjesëmarrjes apo rruga e vetme drejt drejt dinjitetit njerëzor;
38. Të vazhdojmë mbështetjen e punës kërkimore shkencore në të gjitha nivelet, veçanërisht në fushën e teknologjive të informacionit dhe të komunikimit, në mënyrë që të përmirësohen mjetet ndihmëse të cilat mbështesin pjesëmarrjen dhe ndërveprimin e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e jetës;
39. Të marrim të gjitha masat e nevojshme për realizimin e shanseve të barabarta midis burrave dhe grave, si dhe për promovimin e pjesëmarrjes aktive të personave me aftësi të kufizuara, me fokus të veçantë ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në fushat e arsimimit, kualifikimit profesional, punësimit, politikave sociale, pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes, seksualitetit, përfaqësimit social, mëmësisë, jetës familjare dhe shtëpiake, si dhe ndaj parandalimit të dhunës;
40. Të vazhdojmë më tej analizimin e fushëveprimit të masave dhe dispozitave ligjore të cilat mund të kenë ndikim pozitiv dhe efektiv në jetesën e personave me aftësi të kufizuara të cilët kanë nevojë për përkujdesje të veçanta, si dhe të mblidhen të dhënat e nevojshme statistikore për hartimin dhe vlerësimin e politikave të aftësisë së kufizuar;
41. Të vlerësojmë me kujdes të veçantë nevojat e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, nga ana e autoriteteve kompetente, në mënyrë që të mundësohet dhënia e një mbështetjeje, e cila të ndihmojë fëmijët të rriten në gjirin e familjeve të tyre, të përfshihen në jetën e fëmijëve të komunitetit të tyre lokal, si dhe të arsimohen;
42. Të vlerësojmë nevojat e familjeve të personave me aftësi të kufizuara si dhënës shërbimesh informale; në mënyrë të veçantë të vlerësohen nevojat e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara, si dhe nevojat e familjeve me personave me aftësi të kufizuara me nevoja të veçanta për përkujdesje, në mënyrë që të mundësohet dhënia e informacionit, trajnimit, dhe asistencës, përfshirë këtu mbështetjen psikologjike, në mënyrë që të mbështetet jeta në gjirin e familjes;
43. Të punojmë për hartimin e programeve dhe gjetjen e burimeve për plotësimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara, përgjatë procesit të moshimit të tyre;
44. Të promovojmë praktika të jetesës së shëndetshme në popullatë, në mënyrë që moshimi të jetë sa më aktiv, brenda standardeve më të mira të mundshme të shëndetit fizik dhe mendor;
45. Të punojmë drejt zhvillimit të imazhit pozitiv të personave me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara, përfshirë këtu edhe mediat;
46. Të përfshijmë personat me aftësi të kufizuara në marrjen e vendimeve që i prekin ata në mënyrë të drejtpërdrejtë, si personalisht, ashtu edhe nëpërmjet organizatave të personave me aftësi të kufizuara;

kujdes i veçantë t'i tregohet marrjes së mendimit të personave me aftësi të kufizuara të shumëfishta, të atyre me shqetësime komplekse, si dhe personave me aftësi të kufizuara të cilët nuk kanë mundësinë e përfaqësimit të drejtpërdrejtë;

47. Të nxitim përfshirjen dhe bashkëpunimin e partnerëve socialë, si dhe i gjithë partnerëve publikë dhe privatë të përfshirë në vendimmarrje;

5. Rekomandojmë:

48. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës të vazhdojë promovimin e politikave në funksion të garantimit të të drejtave të plota qytetare dhe pjesëmarrjes aktive të personave me aftësi të kufizuara, me pjesëmarrjen e plotë të të gjitha vendeve anëtare; gjithashtu të vazhdojë fuqizimi i rolit të Këshillit të Evropës si platforma më e mirë e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e politikbërjes së aftësisë së kufizuar, duke ftuar Komitetin për Rehabilitimin dhe Integrimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe komitetet e tjerë kompetentë të Këshillit të Evropës të marrin pjesë në përpjekjen për integrimin e politikave të aftësisë së kufizuar në të gjitha fushat e punës së tyre;

49. Të hartohet një Plan Evropian Veprimi i Këshillit të Evropës për Personat me Aftësi të Kufizuara, i bazuar në punimet e kësaj konference ministrore; të hartohet një kuadër i ri i politikbërjes evropiane për dekadën në vazhdim, i bazuar në të drejtat e njeriut dhe në partneritetin midis aktorëve të ndryshëm; të përcaktohen objektiva dhe prioritetet strategjike në mënyrë që të garantohen të drejtat e plota qytetare të personave me aftësi të kufizuara, si dhe të arrihet pjesëmarrja aktive e tyre në jetën e komunitetit nëpërmjet politikave të zbatueshme, të qëndrueshme, dhe të financueshme;

50. Këshilli i Evropës të luajë një rol aktiv negociues në kuadrin e seancave të ardhshme të Komitetit *ad hoc* të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i krijuar me mandatin “e shqyrtimit të propozimeve lidhur me një konventë të përgjithshme dhe të plotë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara”, duke shfrytëzuar për këtë qëllim përvojën e madhe të Këshillit të Evropës në çështje që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut;

6. Ftojme:

51. Të gjitha vendet anëtare në Këshillin e Evropës, vendet me status vëzhguesi, si dhe përfaqësuesit e organizateve joqeveritare evropiane, të marrin pjesë në aktivitetet dhe punimet e Këshillit lidhur me përmirësimin e një politike koherente për dhe nëpërmjet pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara;

7. Shpresojmë:

52. Të ndajmë të njëjtat bindje, vlera dhe parime lidhur me të drejtat njerëzore dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara, si dhe të drejtat qytetare dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën e komunitetit, sipas përcaktimeve të kësaj deklarate të ministrave evropianë, dhe të njohura si vlera të përbashkëta evropiane, me të gjithë njerëzit, përfshirë këtu edhe njerëzit jashtë Evropës.

Në përfundim, falenderojmë autoritetet spanjolle për organizimin e shkëlqyer të konferencës, si dhe për mikpritjen e tyre bujare.

Shtojca 2 e Planit të Veprimit

Bibliografia

Konventa mbi Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (ETS Nr. 5)

Karta Sociale Evropiane (ETS Nr. 35) dhe Karta Sociale Evropiane (e rishikuar)(ETS Nr. 163);

Kodi Evropian i Sigurisë Shoqërore (ETS Nr. 48), Protokollin e Kodit Evropian të Sigurisë Shoqërore (ETS Nr. 48A), Kodi Evropian i Sigurisë Shoqërore (i rishikuar) (ETS Nr. 139);

Konventa mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Dinjitetit të Qenies Njerëzore në Fushën e Aplikimit të Biologjisë dhe Mjekësisë: Konventa mbi të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë (ETS Nr. 164);

Konventa Evropiane mbi Trashëgiminë Arkitektonike (ETS Nr. 121);

Konventa mbi Pejshazhin (ETS Nr. 176);

Strategjia për Kohzionin Social, miratuar më 12 Maj 2000 nga Komiteti Evropian i Kohzionit Social të Këshillit të Evropës;

Rekomandimi Nr. R (86) i Komitetit të Ministrave mbi Kartën Evropiane të Sportit për të gjithë: Personat me aftësi të kufizuara;

Rekomandimi Nr. R (92) 6 i Komitetit të Ministrave mbi një politikë koherente në favor të personave me aftësi të kufizuara;

Rezoluta ResAP (95)3 lidhur me Kartën mbi Vlerësimin Profesional të Personave me Aftësi të Kufizuara;

Rekomandimi Nr. R (96) 5 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me bashkërendimin e jetës familjare me atë profesionale;

Rekomandimi Nr. R (98) 3 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin e arsimit të lartë;

Rekomandimi Nr. R (98) 9 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me varësinë;

Rekomandimi Nr. R (99) 4 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me mbrojtjen ligjore për të rriturit me aftësi të kufizuara;

Rekomandimi Rec (2001)12 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me dhënien e shërbimeve mjekësore dhe shëndetësore në përputhje me kërkesat shëndetësore dhe mjekësore të personave në nevojë;

Rekomandimi Rec (2001)19 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike në nivelin lokal;

Rekomandimi Rec (2002)5 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me mbrojtjen e gruas nga dhuna;

Rekomandimi Rec (2003)3 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në politikë dhe në vendimmarrjen publike;

Rekomandimi Rec(2003)19 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me përmirësimin e ushtrimit të të drejtave sociale;

Rekomandimi Rec (2004)10 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara mendore;

Rekomandimi Rec (2004)11 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me standardet ligjore, teknike dhe operative për votimin elektronik (“e-voting”);

Rekomandimi Rec (2004)15 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me qeverisjen elektronike (“e-governance”);

Rekomandimi Rec (2005)5 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare lidhur me të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucionet rezidenciale;

Rezoluta ResAP (2001)1 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi përdorimin e parimeve të Projektimit Universal në kurrikulat e të gjitha profesioneve që kanë lidhje me mjedisin ndërtimor (“Rezoluta Tomar”)

Rezoluta ResAP (2001)3 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Drejt të drejtave të plota qytetare të personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet teknologjive të reja përfshirëse”;

Rezoluta ResAP (2005)1 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me mbrojtjen e të rriturve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara kundër abuzimeve;

Rekomandimi 1185 (1992) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mbi politikën e rehabilitimit në favor të personave me aftësi të kufizuara;

Rekomandimi 1418 (1999) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të të sëmurëve terminalë dhe të pashërueshëm;

Rekomandimi 1560 (2002) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës “Drejt përpjekjeve të bashkërenduara për trajtimin dhe kurimin e dëmtimeve të shtyllës kurrizore”;

Rekomandimi 1592 (2003) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës “Drejt përfshirjes së plotë sociale të personave me aftësi të kufizuara”;

Rekomandimi 1598 (2003) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mbi mbrojtjen e gjuhëve me shenja në vendet anëtare të Këshillit të Evropës;

Rekomandimi 1601 (2003) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mbi përmirësimin e jetesës së fëmijëve të braktisur në institucionet e përkujdesjes;

Rekomandimi 1698 (2005) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mbi të drejtat e fëmijëve në institucionet e përkujdesjes;

Rezoluta 216 (1990) e Konferencës së Përhershme të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës (aktualisht i njohur si Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës -Kongresi) mbi rehabilitimin dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara: roli i autoriteteve lokale;

Rekomandimi 129 (2003) dhe Rezoluta 153 (2003) e Kongresit lidhur me punësimin e grupeve në nevojë;

Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në nivel lokal dhe rajonal (Kongresi), 21 Maj 2003;

Deklarata Finale e miratuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeveritë e Vendeve Anëtare të Këshillit të Evropës në Samitin e Dytë të Këshillit të Evropës të mbajtur në Strasburg (Tetor 1997), e cila theksoi se *“kohezioni social përbën njërën ndër nevojat kryesore të një Evrope të zgjeruar, ndaj duhet të konsiderohet si element thelbësor i promovimit të të drejtave dhe dinjitetit të njeriut”*;

Deklarata Finale (Deklarata e Maltës) e miratuar në Konferencën e Këshillit të Evropës mbi të Drejtat Sociale, 14-15 Nëntor 2002;

Kontributet e Komisionerit Evropian për të Drejtat e Njeriut;

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (1989);

Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966);

Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966);

Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara (1948);

Rregullat Standarde të Kombeve të Bashkuara mbi Barazimin e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara (1993);

Deklarata e Salamankës (UNESCO) dhe Kuadri i Veprimit për Arsimin Special (1994);

Plani Ndërkombëtar i Veprimit për Moshimin, i miratuar nga Asambleja e Dytë Botërore mbi Moshimin, Madrid, 8 – 12 Prill 2002;

Strategjia Rajonale për Zbatimin e Planit Ndërkombëtar të Veprimit për Moshimin të vitit 2002, e miratuar nga Komisioni Ekonomik i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Evropën në Konferencën Ministrore për Moshimin, Berlin 11-13 Shtator 2002;

Klasifikimi Ndërkombëtar i Dëmtimeve, Aftësisë së Kufizuar dhe Invaliditetit, (ICIDH) (1980) i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH – WHO);

Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF) (2001) i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH – WHO);

Konventa mbi Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin (Personat me Aftësi të Kufizuara) e Organizatës Botërore të Punës (OBP – ILO) (Nr.CI 159) dhe rekomandimi përkatës i ILO mbi Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin (Personat me Aftësi të Kufizuara) (Nr.168), 1983;

Rezoluta e Mbledhjes së Këshillit të Evropës me Ministrat e Arsimit të Vendeve Anëtare e datës 31 Maj 1990 lidhur me integrimin e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në sistemin e arsimit të përgjithshëm;

Komunikimi i Komisionit të Shanseve të Barabarta për Personat me Aftësi të Kufizuara: Një Strategji e Re e Komunitetit Evropian për Personat me Aftësi të Kufizuara (COM(96) 406 -dokumenti final);

Rezoluta e Këshillit të Komunitetit Evropian dhe e përfaqësuesve të qeverive të vendeve anëtare e takimit të 20 dhjetorit të vitit 1996 mbi shanset e barabarta të personave me aftësi të kufizuara;

Rekomandimi i Këshillit e 4 Qershorit 1998 mbi kartën e parkimit për personat me aftësi të kufizuara (98/376/EC);

Rezoluta e Këshillit e 17 Qershorit 1999 mbi shanset e barabarta për personat me aftësi të kufizuara (1999/C 186/02);

Komunikimi i Komisionit për Këshillin e Evropës, Parlamentin Evropian, Komitetin për Çështjet Ekonomike dhe Sociale, dhe Komitetin e Rajoneve: Drejt një Evrope pa Barriera për Personat me Aftësi të Kufizuara (COM(2000) 284 –dokumenti final);

Direktiva e Këshillit (2000/78/EC) e 27 Nëntorit të vitit 2000 mbi krijimin e një kuadri të përgjithshëm për shanse të barabarta në fushën e punësimit;

Vendimi i Këshillit (2000/78/EC) e 27 Nëntorit të vitit 2000 mbi hartimin e një plani pune të Komunitetit Evropian për luftën kundër diskriminimit për periudhën 2001-2006;

Vendimi i Këshillit (2001/903/EC) i 3 dhjetorit të vitit 2001 mbi shpalljen e Vitit Evropian të Personave me Aftësi të Kufizuara (viti 2003);

Rezoluta e Këshillit e datës 6 shkurt të vitit 2003 mbi “Përdorimin pa barriera të sistemeve kompjuterike” – për përmirësimin e qasjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë e informacionit, (2003/C 39/03);

Rezoluta e Këshillit e datës 5 Maj 2003 mbi shanset e barabarta për nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuara në arsimim dhe trajnim (2003/C 134/04);

Rezoluta e Këshillit e datës 6 Maj 2003 mbi përdorueshmërinë e infrastrukturës kulturore dhe aktivitetet kulturore për personat me aftësi të kufizuara (2003/C 134/05);

Rezoluta e Këshillit e datës 15 Korrik 2003 mbi promovimin e punësimit dhe integritit social të personave me aftësi të kufizuara (2003/C 175/01);

Komunikimi nga Komisioni për Këshillin e Evropës, Parlamentin Evropian, Komitetin Ekonomik dhe Social, dhe Komitetin e Rajoneve mbi përdorueshmërinë e teknologjisë së informacionit nga personat me aftësi të kufizuara (COM(2005) 425 –dokumenti final);

Komunikimi nga Komisioni për Këshillin e Evropës, Parlamentin Evropian, Komitetin Ekonomik dhe Social, dhe Komitetin e Rajoneve mbi zbatimin, rezultatet dhe vlerësimin e përgjithshëm të Vitit Evropian të Personave me Aftësi të Kufizuara 2003 (COM(2005) 486 – dokumenti final);

Komunikimi nga Komisioni për Këshillin e Evropës, Parlamentin Evropian, Komitetin Ekonomik dhe Social, dhe Komitetin e Rajoneve mbi situatën e personave me aftësi të kufizuara në Bashkimin e zgjeruar Evropian: Plani Evropian i Veprimit 2006-2007 (COM(2005) 604 –dokumenti final);

Komunikimi nga Komisioni për Këshillin e Evropës, Parlamentin Evropian, Komitetin Ekonomik dhe Social, dhe Komitetin e Rajoneve mbi shanset e barabarta për personat me aftësi të kufizuara: Një Plan Evropian Veprimi (COM(2003) 650 – dokumenti final);

Deklarata e Madridit “Jo-diskriminimi dhe rezultatet e veprimit pozitiv në fushën e përfshirjes sociale” e miratuar në Konferencën Evropiane të organizatave joqeveritare të mbajtur në Madrid në mars të vitit 2002;

Deklarata e Barcelonës: Qyteti dhe Personat me Aftësi të Kufizuara (1995);

Deklarata e Partnerëve Socialë Evropianë mbi Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (Këln, Maj 1999);

Deklarata e Partnerëve Socialë për Vitin Evropian të Personave me Aftësi të Kufizuara: Promovimi i Shanseve të Barabarta dhe i Mundësive të Punësimit për personat me aftësi të kufizuara (20 Janar 2003);

Kontributi i Lëvizjes Evropiane të Aftësisë së Kufizuar në Konferencën e Dytë Evropiane të Këshillit të Evropës mbi Aftësinë e Kufizuar “Nga fjalët tek faktet”, i miratuar në forumin evropian të organizatave joqeveritare të mbajtur më 8 Prill 2003 në Madrid.